



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E FINANCAVE – MINISTARSTVO FINANSIJE – MINISTRY OF FINANCE



NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE

RAPORTI VJETOR 2017



**NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE
FINANSIJSKA OBAVEŠTAJNA JEDINICA
FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT**

RAPORTI VJETOR 2017

PËRMBAJTJA

1. HYRJA	7
2. ORGANIZIMI I NJIF KOSOVA	8
2.1. Buxheti dhe Prokurimi	8
2.1.1. Buxheti	8
2.1.2. Aktivitetet e Prokurimit.....	9
2.2. Organizimi i NJIF-K	9
2.2.1. Mbikëqyrja e NJIF-K.....	9
2.2.2. Burimet njerëzore dhe Struktura organizative e NJIF-K.....	9
3. ZHVILLIMET LIGJORE PËR PPP/LFT	11
3.1. Aktet nënligjore	11
➤ Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017 për Përfundimin e Transaksioneve të Caktuara nga Raportimi (plotësim ndryshim);	11
4. PERFORMANCA E NJIF-K	13
4.1. Pranimi, analizimi dhe shpërndarja e inteligjencës financiare	13
4.1.1. Të dhënat dhe raportet e proceduara	13
4.1.2. Raportimi i Transaksioneve të Dyshimta.....	14
4.1.2.1. <i>Indikatorët e Përgjithshëm dhe specifikë për PPP/PFT</i>	15
4.1.2.2. <i>Raportimi i Transaksioneve të Dyshimta</i>	16
4.1.3. Raportimi i Transaksioneve në para të gatshme (RTG)	21
4.1.4. Raportimi i transaksioneve jo të zakonshme (Monitorimi special i transaksioneve të veçanta)	22
4.1.5. Raportimi i Deklarimit Kufitar (Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës)	22
4.1.6. Ngrirja e transaksioneve bankare	23
4.1.7. Analizimi i raporteve të inteligjencës	24
4.1.8. Hapja e rasteve me iniciativë të NJIF-K.....	24
4.1.9. Shpërndarja e raporteve të inteligjencës.....	25
4.2. Mbikëqyrja e Pajtushmërisë	27
4.2.1. Ndëshkimet administrative dhe masat për përmirësim.....	29
4.2.2. Të dhënat statistikore dhe informatat kthyes.....	29
4.3. Aktivitetet e trajnimeve dhe implementimi i Programit të Trajnimeve	30
4.4. Aktivitetet e ngritjes së vetëdijes	32
4.5. Ngritja e kapaciteteve të NJIF-K	33
4.5.1. Teknologjia Informativë.....	33
4.5.2. Trajnime, konferenca, seminare dhe takime tjera të ndjekura nga personeli i NJIF- K.....	34
5. BASHKËPUNIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR	38
5.1. Bashkëpunimi dhe koordinimi vendor	38
5.1.1. Bashkëpunimi me Agjensionet e Zbatimit të Ligjit dhe institucionet tjera.....	39
5.2. Bashkëpunimi me homologët e huaj dhe Grupin Egmont	41
5.2.1. Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve	41
5.2.1.1. <i>Shkëmbimi në kohë dhe konstruktiv i informacionit</i>	42
5.2.1.2. <i>Ndarja Spontane e Informacionit me NJIF-ët ndërkombëtare</i>	42
5.2.2. Bashkëpunimi regjional.....	43
5.2.3. Memorandumet e Mirëkuptimit	43
5.2.4. Procesi i Anëtarësimit në organizata ndërkombëtare	44
5.2.4.1. <i>Grupi Egmont</i>	44

6. MENAXHIMI I RREZIKUT NË PASTRIM TË PARAVE DHE FINANCIM TË TERRORIZMIT	
45	
6.1. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit 2014-2018.....	45
6.2. Vlerësimet e Rrezikut Sektorial	46
7. MBËSHKETJA NDËRKOMBËTARE	47
7.1. Projektet e financuar nga BE-ja&KiE	47
7.1.1. Projekti i BE&KiE “Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë - Faza II (PECK II)”	47
7.1.2. Projekti i KiE&BE "iPROCEEDS"	50
7.2. Mbështetja nga UNDP	51
7.3. Mbështetja nga OSCE	51
8. PLANI I PERFORMANCËS DHE RESURSEVE TË NJIF-K 2015-2017.....	53
8.1. Grupet Punuese dhe Planet e Veprimit të Strategjive Nacionale.....	54
8.2. Objektivat e përcaktuara në Planin Vjetor të Punës së Ministrisë së Financave dhe Programin e Qeverisë.....	54
8.3. Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA).....	55
8.4. Sfidat për të ardhmen në përmbushjen e planit të performances dhe strategjive tjera kombëtare.....	56

LISTA E SHKURTESAVE

NJIF	Njësia për Inteligjencë Financiare
PPP	Parandalimi i Pastrimit të Parave
PFT	Parandalimi i Financimit të Terrorizmit
LPP/LFT	Luftimi i Pastrimit të Parave/Luftimi i Financimit të Terrorizmit
AIF	Raporti i informacioneve shtesë
AK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
AKK	Agjencia kundër Korrupsionit
AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
ARC	Agjencia për Regjistrim Civil
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BPCJF	Bizneset dhe Profesionet e Caktuara Jofinanciare
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
DBJN	Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar
DHKEK	Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (brenda PK)
DK	Dogana e Kosovës
DKT	Drejtoria kundër Terrorizmit – (brenda PK)
DRNOJQ	Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të
EGMONT	Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë
FATF/TFVF	Task Forca e Veprimit Financiar
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FT	Financimi i Terrorizmit
goAML	Sistemi elektronik i menaxhimit të dhënave
IFJB	Institucionet Financiare Jobankare
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
ILECU	Njësia për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit
IMF	Institucion Mikrofinanciar
IPA	Instrumenti i Asistencës para Anëtarësimit (i Komisionit Evropian)
KDK	Kujdesi i Duhur ndaj Klientit
KiE	Këshilli i Evropës
KKLKE	Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik
KP	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
MF	Ministria e Financave
MM	Marrëveshje e mirëkuptimit
MONEYVAL	Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave
NNJ	Ndihma e Ndërsjellë Juridike
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës

OJQ	Organizatë joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
ONK	Oda e Noterëve të Kosovës
PECK	Projekti i BE&KiE “Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë”
PEP	Personat e Ekspozuar Politikisht.
PK	Policia e Kosovës
PP	Pastrimi i parave
PSO	Procedura Standarde të Operimit
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
QIF	Qendra e Inteligjencës Financiare (paraardhësi i NJIF-it)
RKSOKB	Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara
RTD	Raporti i Transaksionit të Dyshimtë
RTG	Raporti i transaksionit në të gatshme (kesh)
SHKAÇK	Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar të Kosovës
TI	Teknologjia Informative
UNDP	Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara kundër krimit dhe drogave
VKR	Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut
ZKK	Zyra Kadastrale Komunale

1. HYRJA

Në përputhje me mandatin e saj ligjor, Njësia për Inteligjencë Financiare (NJIF-K) paraqet Raportin Vjetor për vitin 2017.

Anëtarësimi i NJIF-K në Egmont Group është një ndër të arriturat më të mëdha të NJIF në vitet e fundit si dhe arritje e madhe për vendin në rrugëtimin tonë për anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

Numri i raportimeve për transaksione të dyshimta është rritur për 50% krahasuar me vitin paraprak. Gjithashtu numrit të raporteve të inteligjencës të shpërndara tek autoritetet tjera ka rezultuar me një ngritje prej rreth 6%.

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi ndërkombëtar i informacionit ka shënuar progres të theksuar duke rritur numrin e kërkesave për informacion.

Gjatë këtij viti janë ndërmarrë hapa për vlerësimin e rrezikut sektorial, duke kryer një vlerësim të rrezikut për sektorin e ndërtimit dhe lojërat e fatit si dhe është iniciuar edhe vlerësimi i rrezikut në sektorin e OJQ-ve. Këto vlerësime kanë shërbyer si bazë për rishikimin e objektivave dhe aktiviteteve të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018 dhe Planit të Veprimit.

Zhvillime të rëndësishme janë bërë në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës ligjore duke nxjerrë dhe hartuar aktet nënligjore dhe procedura standarde të operimit të NJIF-K.

Gjatë këtij viti, NJIF-K ka bërë përpjekje të rëndësishme për të përmirësuar pozitën e saj institucionale, kapacitetet e saj për të zgjeruar bashkëpunimin me autoritetet e tjera vendore dhe ndërkombëtare dhe për të përmirësuar cilësinë e analizës.

Gjithnjë mbetet synim ngritja e kapaciteteve operacionale, shkathtësive analitike dhe kapaciteteve në fushën e teknologjisë informative me qëllim të arritjes së një kualiteti sa më të lartë të të dhënave të ndjeshme financiare të cilat pranohen nga subjektet raportuese.

Bashkëpunimi me subjektet raportuese mbetet i mirë, duke veçuar bashkëpunimin me Bankat dhe institucionet financiare.

Kontribut i rëndësishëm është dhënë edhe në drejtim të hetimeve të mëtutjeshme përmes përcjelljes së informacioneve tek autoritetet tjera të zbatimit të ligjit në lidhje me raportet e transaksioneve të dyshimta apo analizave shitesë dhe formave tjera të bashkëpunimit për dyshimet e mundshme për përfshirje në pastrim të parave, financim të terrorizmit apo ndonjë vepër tjetër të ndërlidhur penale.

2. ORGANIZIMI I NJIF KOSOVA

2.1. Buxheti dhe Prokurimi

2.1.1. Buxheti

Ndryshimet e reja ligjore kanë përcaktuar përdorimin në mënyrë të pavarur të buxhetit të NJIF-K duke specifikuar në nenin 4 të Ligjit për PPP/LFT përkufizimet e reja "NJIF-K ka buxhetin e vet i cili sigurohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit. NJIF-K vendosë në mënyrë të pavarur për shfrytëzim të buxhetit, në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë".

Zyra për Buxhet dhe Financa të NJIF-K, veprimtarinë e vetë e kryen bazuar në ligjin nr. 04/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë të Republikës së Kosovës, dhe ofron mbështetje profesionale në lëmine e planifikimit të buxhetit, Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, Planit të Rrjedhës së Parasë. Përgatit Pasqyrat Financiare nëntë mujore dhe Vjetore në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.

Buxheti i NJIF-K për vitin 2017 dhe procesi i realizimit të tij sikur edhe në vitet e mëparshme, si rezultat i planit mirë të analizuar, dhe në përputhje me objektivat dhe prioritetet e përcaktuara të saj, ka përmbyllur me sukses buxhetin për vitin 2017. Bazuar në procesin e planifikuar të shpenzimit të buxhetit në të gjitha kategoritë ekonomike, gjatë tërë viti 2017 ka arritur shkallën e realizimit 92.96%.

Ndarja buxhetore fillestare sipas Ligjit të Buxhetit Nr.05/L-125 për vitin 2017, ka qenë 378,853 Euro, kurse me rishikim të buxhetit kjo shumë ka ndryshuar në shumën 382,403 Euro.

Kategoritë Ekonomike	Buxheti 2017	Buxheti	Buxheti i shpenzuar	
	ndarja fillestare	pas rishikimit	realizimi	Realizimi %
	1	2	3	4
Paga dhe mëditje	221,520	201,520	185,465	84.36%
Mallra dhe shërbime	115,658	149,908	140,895	93.98%
Shpenzimet komunale	11,475	11,475	9,729	84.78%
Shpenzime kapitale	30,000	19,500	19,389	99.43%
Gjithsej	378,653	382,403	355,478	92.96%

Tabela nr.1 - Tabela e ndarjeve dhe realizimit të buxhetit 2017

2.1.2. Aktivitetet e Prokurimit

Gjatë vitit 2017 sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 janë zhvilluar gjithsej dhjetë (9) aktivitete të prokurimit.

Sipas procedurës aktivitetet e prokurimit janë të ndara në :

- Dy (2) aktivitete të prokurimit me procedurë të hapur,
- Tri (3) aktivitete kanë qenë me procedurën e kuotimit.
- Dy (2) aktivitete të prokurimit me procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.
- Dy (2) aktivitete kanë qenë me procedurën e vlerës minimale.

Ndërsa sipas vlerës se planifikuar të prokurimit

- Tri (3) janë me vlerë të mesme.
- Katër (4) janë me vlerë të vogël dhe.
- Dy (2) janë me vlerë minimale.

2.2. Organizimi i NJIF-K

2.2.1. Mbikëqyrja e NJIF-K

Bordi Mbikëqyrës i Njesisë për Inteligjencë Financiare mbikëqyrë dhe siguron pavarësinë e NJIF-K. Bordi nuk ka fuqi ekzekutive ose zbatimi kundrejt NJIF-K.

Gjatë vitit 2017, Bordi i NJIF-K ka mbajtur takim ku ka shqyrtuar përveç tjerash edhe Raportin e Punës së Njesisë për Inteligjencë Financiare për vitin 2016, informimin për rregullimin e strukturës organizative të NJIF-K, dhe tema tjera në fushën e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe ekonomisë informale.

Bordi kryen edhe funksionin e mekanizmit përgjegjës koordinues për përcaktimin e orientimit të politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të bazuar në rreziqet e identifikuara, si dhe për ngritjen e bashkëpunimit ndër-institucional në pajtim me qëllimet e ligjit për PPP/LFT. Për këtë qëllim, Bordi mund të krijojë grupe pune për të bashkërenduar aktivitetet në fushën e politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe përcaktimin e prioritetëve afatgjata dhe afatshkurtra.

Nisur nga kjo, Bordi mund të ftojë edhe akterë tjerë nga sektori publik dhe privat.

2.2.2. Burimet njerëzore dhe Struktura organizative e NJIF-K

Plani i Përformances dhe Resurseve të Njesisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës 2015-2017 ka përcaktuar menaxhimin e burimeve njerëzore dhe objektivat e NJIF-K.



Në vitin 2017, NJIF-K ka filluar me hartimin e Rregullores për organizimin e brendshëm në Njësinë për Inteligjencë Financiare. Kjo Rregullore përcakton strukturën organizative si dhe organizimin e brendshëm të Njësisë për Inteligjencë Financiare, e cila është themeluar dhe funksionon sipas Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit. Projekt rregullorja pritet të krijoj një strukturë funksionale dhe të pavarur për NJIF-K.




3. ZHVILLIMET LIGJORE PËR PPP/LFT

3.1. Aktet nënligjore

Njësia për Inteligjencë Financiare bazuar në nenin 14 të Ligjit për PPP/LFT është e autorizuar të miratojë akte nënligjore, të lëshojë urdhra dhe udhëzues mbi çështjet që kanë të bëjnë me sigurimin dhe promovimin e pajtueshmërisë të subjekteve raportuese me këtë ligj, gjatë vitit 2017 NJIF-K ka nxjerr aktet nënligjore si në vijim:


- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017 për Përjashtimin e Transaksioneve të Caktuara nga Raportimi (plotësim ndryshim);
 - *Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është lirimi i personave ose subjekteve, apo grup personash ose subjektësh, nga obligimet e raportimit sipas këtij ligji, si dhe metodat për të raportuar lirime të tilla.*
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2017 për Trajnimet për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit;
 - *Njësia për Inteligjencë Financiare (NJIF-K), përmes këtij udhëzimi administrativ përcakton kriteret dhe procedurat për obligimet ligjore lidhur me organizimin dhe kryerjen e trajnimeve të rregullta, përfshirë vetëdijesimin dhe sensibilizimin në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit, të përcaktuar sipas Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.*
- Udhëzuesi për vetë-vlerësim të subjektit raportues për procedurat për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit;
 - *Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ofroj lehtësira në zbatim të obligimet ligjore të përcaktuar sipas Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit. Ky udhëzues ofron një përmbledhje të shkurtër të pyetjeve dhe praktikave më të mirat sa i përket zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe mundësinë që subjektet raportuese përmes tij të vetë-vlerësojnë subjektin e tyre raportues.*
- Rregullorja për Funkcionin e Pajtueshmërisë dhe Kriteret për “i Përshtatshëm” dhe “i Duhur” për Zyrtarin e Pajtueshmërisë për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (rregullore e re).
 - *Përmes kësaj Rregulloreje NJIF-K përcakton detyrat dhe kompetencat e funksionit të pajtueshmërisë dhe kriteret të cilat duhet të përmbushen nga personat të cilët ushtrojnë funksionin e Zyrtarit të Pajtueshmërisë për PPP/LFT në të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka Qendrore për të operuar në Republikën e Kosovës si dhe institucionet tjera financiare.*



- Procedura Standarde të Operimit për Mbikëqyrjen e Pajtueshmërisë;
 - *Qëllimi i kësaj Procedure Standarde e Operimit është përcaktimi i procedurave të inspektimit në terren dhe inspektimit nga distanca, analiza e rrezikut me qëllim të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, mënyra e përcaktimit të kalendarit vjetor të inspektimit, mënyra e ruajtjes së dokumenteve relevante të inspektimit, raportimi i gjetjeve mbikëqyrëse dhe procesi i sanksionimit.*

- Procedura Standarde e Operimit për Shkëmbim Ndërkombëtar të Informatave;
 - *Kjo Procedurë Standarde e Operimit përshkruan bazën ligjore, parimet dhe procedurat e shkëmbimit ndërkombëtar të informacionit të NJIF-K. Natyra dhe shtrirja e këtij bashkëpunimi është definuar në rekomandimet e FATF dhe aktin themelues (kartën) e Grupit Egmont, Parimet dhe Udhëzimet Operacionale të saj.*

Gjithashtu, në fund të vitit 2017 bankat komerciale janë udhëzuar për mënyrën e implementimit të nenit 19, pika 3.2.1 të ligjit për PPP/LFT, përmes udhëzuesit me nr. FIUAD: 189/2017.



4. PERFORMANCA E NJIF-K

4.1. Pranimi, analizimi dhe shpërndarja e inteligjencës financiare


4.1.1. Të dhënat dhe raportet e proceduara

Rekomandimi 33 i Task Forcës për Veprim Financiar (FATF) kërkon që “Vendet duhet të mbajë statistika gjithëpërfshirëse për çështje që lidhen me efektivitetin dhe efikasitetin e sistemeve PPP/FT. Kjo duhet të përfshijë statistikën mbi raportet e transaksioneve të dyshimta të marra dhe të shpërndara; për hetimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, ndjekjeve penale dhe dënimeve; mbi pasuritë e bllokuar, sekuestruar dhe konfiskuar si dhe për ndihmë të ndërsjellë juridike ose kërkesave të tjera ndërkombëtare për bashkëpunim”.

Po ashtu, neni 38 i Ligjit për PPP/LFT kërkon që NJIF-K, BQK, mbikëqyrësit e tjerë sektorial, autoritetet e tjera kompetente që kanë përgjegjësi për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, subjektet raportuese si dhe personat ose subjektet e tjera që kanë detyrime ose funksione sipas këtij ligji mbajnë të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse përkatëse për fushën e tyre të përgjegjësisë.

Të dhënat statistikore të mbajtura sipas ligjit në fjalë vihen në dispozicion të NJIF-K brenda afateve kohore të përcaktuara prej NJIF-K, për t'i mundësuar që të rishikojë efektivitetin e sistemit kombëtar dhe për të bërë rekomandime në përputhje me rrethanat siç kërkohet me ligj.

Në vitin 2017, NJIF-K ka gjeneruar gjithsej 7,949 raporte të regjistruara në sistemin elektronik të përpunimit të të dhënave.



Grafikoni 2: Dinamika e raporteve të procesuara në 2015-2017



Në vitin 2017, numri i raporteve të gjithëmbarshme të pranuar ka shënuar rënie prej 28% krahasuar me një vit më parë. Kjo rënie e raporteve është ndikuar kryesisht nga rënia e numrit të Raporteve të informatave shtesë (rreth 41%). Rezultat i kësaj është rritja e kualitetit të raportimit të transaksioneve të dyshimta nga Bankat dhe institucionet financiare, si dhe rritja e qasjes së NJIF-K në bazat e të dhënave të institucioneve publike.


Viti	2016	2017	+/-
Lloji i Raportit	Numri i të dhënave dhe raporteve të procesuara		
AIF	6,325	3,718	-41%
BCR	2	2	0%
CTR	2,396	2,177	-9%
ER	10	-	-100%
FDR		68	
FRZ	85	3	-96%
INR	17	17	0%
IRD	113	125	11%
IRI	16	33	106%
ORD	1,628	1008	-38%
ORI	13	35	169%
STR (PP)	480	704	47%
TFR	5	7	40%
UTR	23	52	126%
Gjithsej:	11,113	7,949	-28%

Tabela Nr.2 – Numri i raporteve të proceduara përmes sistemit elektronik dhe online 2016-2017

4.1.2. Raportimi i Transaksioneve të Dyshimta

Në pajtim me Ligjin Bazë, subjektet raportuese dorëzojnë në NJIF-K informacionin mbi transaksionet financiare që dyshohet se janë të përfshirë në pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit. Duhet të theksohet se në vitin 2017 NJIF-K regjistroi rreth 50% më shumë raporte mbi transaksionet e dyshimta se sa në vitin 2016.





Grafiku Nr.3 -RTD në muaj të pranuar për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit 2017

4.1.2.1. Indikatorët e Përgjithshëm dhe specifikë për PPP/LFT

Trendët e raportimit të transaksioneve të dyshimta kanë treguar ndryshime nga viti në vit. Në këtë periudhë vërehet një raportim në ngritje i transaksioneve të janë kryer me qëllim të ikjes së prgut të raportimit.

Indikatorët e PP/FT	Nr_i_indikatorëve në RTD
Depozitime të rregullta të shumëfishta në para në të gatshme të cilat duket se janë të ndërlidhura dhe nën pragun raportues prej 10,000 Euro të transaksionit të parave në të gatshme;	97
Aktiviteti i llogarisë është jo-konsistent me profilin e klientit;	85
Depozitimi apo tërheqja e instrumenteve të shumëfishta monetare në shumat të cilat në të vazhdueshme janë shumë afër nën-pragun identifikues apo raportues;	62
Blerja e aseteve në vlerë të lartë (p.sh. patundshmëri, vetura luksoze);	39
Qarkullim i lartë në llogarinë që përfshin shuma të konsiderueshme të fondeve në para në të gatshme;	37
Transaksione të ngjashme të kryera përgjatë një periudhe të shkurtë kohore;	22
Transferet e shumëfishta të fondeve të cilat duket se kanë lidhje me përfituesit e përbashkët;	20
Depozitimi apo tërheqja e parave në të gatshme në shuma të cilat në mënyrë të vazhdueshme janë shumë afër nën-pragun identifikues apo raportues;	18
Evazion Fiskal / Kontrabande / Krimet e taksave	18
Depozitimet në para në të gatshme në vlera të larta për të paguar transferet ndërkombëtare të fondeve;	18
Depozitime të mëdha në para në të gatshme të bëra në llogarinë individuale apo të personit juridik ku normalisht aktiviteti i biznesit të individit apo personit juridik	15

mund të bëhet në metoda tjera të pagesës;	
Transaksioni nuk ka ndonjë qëllim racional (të qartë dhe relevant) ekonomik apo biznesor;	12
Transferet e shumëfishta të fondeve në vlera të ulëta të cilat duket se janë të ndërlidhura;	20
Përdorimi i llogarive të huaja të anëtarëve të familjes, të emëruarve etj;	10
Profesioni i deklaruar i transferuesit nuk korrespondon me nivelin apo llojin e aktivitetit, për shembull, studenti apo individi i papunë i cili pranon apo dërgon numër të mëdha të transfereve elektronike, apo i cili bën tërheqje të shumëfishta maksimale	10

Tabela Nr.3 – Indikatorët e PP/FT


4.1.2.2. Raportimi i Transaksioneve të Dyshimta 2011-2017

Në total, që nga viti 2011, 2417 raporte të transaksioneve/aktivitetit të dyshimtë janë pranuar nga NJIF-K.

Vitet	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
RTD-të e pranuar	135	202	174	295	398	485	728

Tabela nr.4 - Numri i RTD-ve të raportuara 2011-2017

Duhet të theksohet se në 2017 NJIF-K regjistroi 50% më shumë raporte mbi transaksionet e dyshimta se në vitin 2016.




Grafiku Nr.3-Numri i RTD-ve të raportuara 2011-2017

Në mesin e subjekteve që kanë detyrime të raportimit, bankat janë ndër më aktivet në raportimin e aktiviteteve ose transaksioneve të dyshimta apo rreth 94% e raportimit të gjithëmbarshtëm të RTD-ve, të përcjella nga Agjensionet për Transfer Parash me 5 %.



Masat vetëdijësuese dhe mbikëqyrja e pajtueshmërisë do të ushtrohet më tepër tek Bizneset dhe Profesionet e Caktuara Jofinanciare për përmbushjen e obligimeve të tyre ligjore që do të fuqizohen duke ndërmarrë veprime drejt organizimit dhe mbajtjes së trajnimeve dhe duke ngritur aktivitetet e mbikëqyrjes së pajtueshmërisë bazuar në rrezik me qëllim të pajtueshmërisë e tyre me legjislacionin në fuqi.



Grafikoni nr.4- Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve2017




Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve 2011-2017								
Subjektet Raportuese	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Gjithsej 2011-2017
Bankat	129	196	165	234	350	438	683	2195
Institucionet Mikrofinanciare	-	-	-	-	2	6	5	13
Kompanitë e Sigurimeve	-	-	-	-	-	-	-	0
Këmbimoret (Këmbimi i valutave)	-	-	-	1	-	-	-	1
Agjensionet për Transfer Parash	3	6	6	58	39	34	34	180
Kazino	-	-	-	-	-	-	-	0
Agjentët e patundshmërive	-	-	-	-	-	-	-	0
Tregtarët me metale/gurë të çmuar	-	-	-	-	-	-	-	0
Avokatët	-	-	-	-	-	-	-	0
Noterët	-	-	1	-	-	2	-	3
Kontabilistët e certifikuar dhe këshilltarët tatimor	-	-	-	-	-	-	-	0
Auditorët e licencuar	-	-	-	-	-	-	-	0
Ofruesit e shërbimeve të trustit dhe kompanive	-	-	-	-	-	-	-	0
Profesionistët e tjerë	-	-	-	-	-	-	-	0
Organizatat Jo-Qeveritare	-	-	-	-	-	-	-	0
Shitësit e metaleve të çmuara dhe tregtarët me gurë të çmuar	-	-	-	-	-	-	-	0
Dogana e Kosovës	3	-	1	1	4	1	-	10
Mbikëqyrësit sektorial	-	-	-	-	2	2	4	8
Tjera	-	-	1	1	1	2	2	7
Gjithsej RTD-të e raportuar 2011-2016	135	202	174	295	398	485	728	2417

Tabela nr.5- Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve 2011-2017




Informacionet statistikore mbi raportet e dyshimta (RTD) te pranuar nga NJIF										
Subjekti raportues	2013		2014		2015		2016		2017	
	Raportet në lidhje me transaksionet e dyshimta		Raportet në lidhje me transaksionet e dyshimta		Raportet në lidhje me transaksionet e dyshimta		Raportet në lidhje me transaksionet e dyshimta		Raportet në lidhje me transaksionet e dyshimta	
	PP	FT	PP	FT	PP	FT	PP	FT	PP	FT
Bankat dhe Institucionet Financiare										
Bankat Komercale	159	6	219	15	327	23	419	19	673	10
Institucionet Mikrofinanciare	0	0	0	0	2	0	6	0	5	0
Kompanitë e Sigurimeve	0	0	0	0	0	0	0	0		
Këmbimoret (Shkëmbimi i valutave)	0	0	1	0	0	0	0	0		
Agjensionet për Transfer Parash	6	0	57	1	36	3	19	15	26	8
Gjithsej Bankat dhe Institucionet Financiare	165	6	277	16	365	26	444	34	704	18
BPPJF-të dhe Entitetet tjera raportuese										
Kazino	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Agjentët e patundshmërive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Tregtarët me metale/gurë të çmuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Avokatët	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Noterët	1	0	0	0	0	0	2	0	0	0
Kontabilistët e certifikuar dhe këshilltarët tatimor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Auditorët e licencuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Ofruesit e shërbimeve të trustit dhe kompanive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Profesionistët e tjerë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Organizatat Jo-Qeveritare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shitësit e metaleve të çmuara dhe tregtarët me gurë të çmuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kompanitë e ndërtimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej BPPJF-të dhe Entitetet tjera Raportuese	1	0	0	0	0	0	2	0	0	0
Raportet dhe informacionet tjera të dyshimta										
Dogana e Kosovës	0	1	1	0	4	0	1	0	0	0
Mbikëqyresit sektorial	0	0	0	0	2	0	1	1	4	0
Tjera	1	0	1	0	1	0	1	1	2	0
Gjithsej raportet dhe informacionet tjera	1	1	2	0	7	0	3	2	6	0
Gjithsejtë RTD e pranuar për PP/FT	167	7	279	16	372	26	449	36	710	18
Gjithsej RTD e raportuara	174		295		398		485		728	

Tabela nr.6 - Informacionet për raportet e dyshimta (RTD) për PP dhe FT te raportuara në NJIF-K 2013-2017



Të dhënat statistikore tregojnë që gjatë vitit 2017, gjithsej 18 raporte të aktivitetit të dyshimtë për financim të terrorizmit janë pranuar në NJIF-K. Ky numër i RTD-ve për financim të terrorizmit është ndikuar kryesisht nga raportimet e bëra nga Agjensionet për Transfer Parash, gjë që është e kuptueshme marrë parasysh përdorimin e këtij sistemi për bartjen e fondeve për qëllime të dyshuara për financim të terrorizmit.




Grafiku Nr.5– RTD të raportuara për Finanim të Terrorizmit 2013-2017

Informacionet statistikore mbi raportet e dyshimta (RTD) të raportuara për Finanim të Terrorizmit 2013-2017 sipas sektorëve					
Subjekti raportues	2013	2014	2015	2016	2017
Bankat Komerçiale	6	15	23	19	10
Institucionet Mikrofinanciare	-	-	-	-	-
Agjensionet për Transfer Parash	-	1	3	15	8
Këmbimoret (Shkëmbimi i valutave)	-	-	-	-	-
BPPJF-të	-	-	-	-	-
Mbikëqyrësit sektorial	-	-	-	1	-
Dogana e Kosovës	1	-	-	-	-
Tjera	-	-	-	1	-
Gjithsej RTD-të për Finanim të Terrorizmit	7	16	26	36	18

Tabela nr.7 - Informacionet për raportet e dyshimta (RTD) për FT të pranuar nga NJIF-K 2013-2017

4.1.3. Raportimi i Transaksioneve në para të gatshme (RTG)

Transaksionet në para të gatshme përbëjnë volumnin më të madh të raporteve të pranuar në NJIF-K. Vërehet një ngritje e vogël (8%) e numrit të raportimit të RTG-ve në vitin 2017 krahasuar me një vit më herët. Shprehur në vlera monetare, raportimi i transaksioneve në para të gatshme ka mbetur i përafërt me vitin e kaluar.



Grafiku Nr.6 – Numri i RTG-ve të pranuar 2012-2017

Raportet në lidhje me transaksionet mbi pragun e raportimit (RTG) të pranuar								
Subjekti raportues	2014		2015		2016		2017	
	Numri i Raporteve të pranuar	Numri i Transaksioneve	Numri i Raporteve të pranuar	Numri i Transaksioneve	Numri i Raporteve të pranuar	Numri i Transaksioneve	Numri i Raporteve të pranuar	Numri i Transaksioneve
Bankat dhe Institucionet Financiare								
Bankat	1,700	548,139	2,028	614,162	2,087	774,463	1,992	835,781
Institucionet Mikrofinanciare	12	37	12	25	22	184	16	384
Sektori i Sigurimeve	3	11	0	0	0	0	0	0
Këmbimoret (Shkëmbimi i valutave)	297	2959	292	1875	297	2384	264	2122
Agjensionet për Transfer Parash	25	500	23	104	18	99	5	213
Gjithsej Bankat dhe Institucionet Financiare	2,037	551,646	2,355	616,166	2,424	777,130	2,277	838,500
ENTITETET TJERA RAPORTUESE								
Dogana e Kosovës	12	2005	12	1264	12	1156	12	1108
Gjithsej ENTITETET TJERA RAPORTUESE	12	2005	12	1264	12	1156	12	1108
Gjithsej RTD e pranuar	2,049	553,651	2,367	617,430	2,436	778,286	2,289	839,608

Tabela nr.8-Raportet në lidhje me transaksionet mbi pragun e raportimit (RTG) sipas sektorëve'14-'17




4.1.4. Raportimi i transaksioneve jo të zakonshme (Monitorimi special i transaksioneve të veçanta)

Bazuar në nenin 25 të Ligjit për PPP/LFT, subjektet raportuese janë të obliguara t'i kushtojnë vëmendje të veçantë marrëdhënieve afariste dhe transaksioneve me personat, duke përfshirë personat juridik dhe marrëveshjet juridike dhe institucionet financiare nga ose në vende që nuk i aplikojnë ose i aplikojnë në mënyrë të pamjaftueshme standardet ndërkombëtare përkatëse për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Subjektet raportuese shqyrtojnë deri në masën e mundshme sfondin dhe qëllimin e transaksioneve të tilla dhe paraqesin me shkrim gjetjet e tyre dhe informacionin specifik në lidhje me transaksionet e tilla.

Në vitin 2017, NJIF-K përmes 52 raporteve të tilla është njoftuar në lidhje me disa prej aktiviteteve ose transaksioneve jo të zakonshme.



Grafiku Nr.7 – Numri i UTR-ve të pranuar 2012-2017

4.1.5. Raportimi i Deklarimit Kufitar (Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës)

Deklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare mbetet i përafërt me vitet paraprake. Bazuar në harmonizimin e statistikave vjetore mes NJIF-K dhe Doganës, në vitin 2017, është raportuar se personat fizik dhe juridik kanë deklaruar gjithsej 1,108 Raporte të Deklarimit Kufitar (RDK), krahasuar me 1,156 RDK të deklaruara një vit më parë.

Dogana e Kosovës si zbatuese e kësaj dispozite ligjore, vazhdon të raportojë rregullisht numrin e deklarimeve të tilla.



Deklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare			
Numri i Raporteve të deklaruara			
Vitet	Personat Juridik	Personat Fizik	Numri i deklarimit te RTG-ve
1	2	3	4 = (2+3)
2017	664	444	1,108
2016	732	424	1,156
2015	606	658	1,264
2014	667	583	1,250
2013	553	543	1,096
Gjithsej	1,826	1,784	3,610


Tabela nr.9 - Deklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare 2013-2017

4.1.6. Ngrirja e transaksioneve bankare

Në vitin 2017, NJIF-K ka lëshuar 3 udhëzime për pezullim të përkohshëm të transaksionit ose ngrirje të llogarisë, shprehur në vlerë totale në shumë prej rreth 1 milion euro, përderisa në vitin 2016 janë lëshuar 85 urdhëresa të tilla në vlerë totale prej rreth 1.1 mil Euro, kurse në vitin 2014 numri i urdhëresave të lësuara nga NJIF-K ka qenë 20 dhe janë ngrirë fonde në vlerë prej rreth 774,115 Euro.

Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit	2014	2015	2016	2017
Numri i udhëzimeve të lësuara për pezullim të transaksionit	20	6	85	3
Shuma (EUR)	774,115	29,740	1,036,146	1,007,933

Tabela nr.10 -Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit 2014-2017



Grafiku Nr.8 – Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit 2014-2017



4.1.7. Analizimi i raporteve të inteligjencës

NJIF-K është e autorizuar të marrë dhe analizojë raportet dhe informacionet:

- të bëra dhe të ruajtura sipas neneve 16 deri në 33 të këtij ligji;
- që i janë ofruar NJIF-K-së nga NJIF-të e vendeve të huaja me funksione të ngjashme, nga gjykatat ose nga organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit, duke përfshirë organizatat ndërqeveritare e ndërkombëtare, organet publike ose qeveritare; dhe
- që i janë ofruar vullnetarisht NJIF-K-së në lidhje me dyshimet për pastrimin e parave, veprat e ndërlydhura penale dhe/ose financimit të terrorizmit


Rreth 457 % e rasteve të hapura në këtë vit kanë rrjedhur nga raportet e transaksioneve të dyshimta, përderisa kërkesat për informata përbëjnë rreth 45% të numrit total të rasteve të hapura gjatë këtij viti raportues. Ka shënuar ngritje gjithashtu edhe ngritja e numrit të rasteve nga projektet e përbashkëta të analizave/hetimeve me Institucionet tjera të zbatimit të ligjit.

Rastet e Hapura	2015	2016	2017
Rastet e hapura bazuar në RTD	125	180	147
Rastet e hapura nga NJIF-K (informacioni anonim)	14	18	6
Rastet e hapura nga Informatat Spontane nga FIU tjera	1	1	5
Kërkesat për informata	106	113	140
Projektet e përbashkëta të analizave/hetimeve me Institucionet tjera të zbatimit të ligjit	1	6	12
Gjithsej Rastet e Hapura	247	318	310

Tabela Nr.11 -Rastet e Hapura 2015-2017

4.1.8. Hapja e rasteve me iniciativë të NJIF-K

Qasja proaktive e NJIF-K në drejtim të zhvillimeve dhe ngjarjeve të lidhura me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit është ndjekur edhe gjatë vitit 2016. Numri më i madh i rasteve të hapura me vetë-iniciativë ka ardhur nga analizimi periodik i Raporteve të parave në të gatshme dhe transaksionet jo të zakonshme, si dhe nga informacioni spontan i dërguar nga NJIF-ët ndërkombëtare.



Grafiku Nr.9 - Rastet e iniciuara dhe propozuara me iniciativë të NJIF-K sipas burimit 2017

Propozim për hapje të rasteve me iniciative të NJIF-K	2017	%
Propozim për hapje të rasteve bazuar në analizimin e RTG-ve, UTR-ve	7	33.33%
Informacioni i pranuar nga Institucionet Publike	2	9.52%
Propozim për hapje të rasteve bazuar në informacionet e marruara nga media	1	4.76%
Informacioni spontan i dërguar nga NJIF ndërkombëtare	7	33.33%
Inspektim i Pajtushmërisë	0	0.00%
Informacioni i ofruar vullnetarisht NJIF-K-së në lidhje me dyshimet për shpëlarjen e parave ose financimit të aktiviteteve terroriste	4	19.05%
Gjithsej Rastet e Hapura	21	100.00%

Tabela Nr.12 - Rastet e iniciuara dhe propozuara me iniciative të NJIF-K sipas burimit 2017

4.1.9. Shpërndarja e raporteve të inteligjencës

Me iniciativën e vet ose sipas kërkesës, NJIF-K mund të shpalojë informacionin tek organet publike apo qeveritare ose tek subjektet raportuese, nëse shpaloja e tillë konsiderohet si e nevojshme nga NJIF-K, apo do t'i shërbente ose do të ndihmonte NJIF-K që të kryejë detyrat e veta.

Rezultati i analizave për të cilat dyshohet për pastrim të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financim të terrorizmit, mund të shpërndahet dhe shkëmbehet me iniciativën e vet ose sipas kërkesës, nga NJIF-K me autoritetet vendore dhe ato me kompetenca vendore, nëse informacioni i tillë është relevant për hetime në kuadër të kompetencës së tyre si dhe organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit ose ndonjë organ jashtë Kosovës me funksion të ngjashëm me NJIF-K.


Gjatë vitit 2017, NJIF-K ka përgatitur 119 raporte të inteligjencës dhe i ka dorëzuar ato tek organet kompetente për hetime të mëtutjeshme. Si çdo herë, numrin më të madh të referimeve e përbën Policia e Kosovës me 50% të numrit të raporteve të shpërndara.

Raportet e shpërndara të inteligjencës/referuar në	2017	%
Policia e Kosovës	60	50%
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës	4	3%
Administrata Tatimore e Kosovës	40	34%
Dogana e Kosovës	2	2%
Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	1	1%
Agjencia Kundër Korrupsionit	3	3%
EULEX	2	2%
FIU ndërkombëtare/Informacion Spontan	5	4%
Tjera	2	2%
Gjithsej raportet e shpërndara të inteligjencës	119	100%

Tabela Nr.13 - Raportet e inteligjencës të shpërndara/referuara në institucione përkatëse 2017



Krahasuar me vitin paraprak, shënohet një ngritje prej 6% e referimeve për hetime të mëtutjeshme. Shpërndarja e raporteve të inteligjencës tek agjensionet tjera vendore dhe ndërkombëtare për periudhën 2012 – 2017, është paraqitur në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:



Grafikoni Nr.10 – Raportet e shpërndara të inteligjencës 2012-2017

Raportet e shpërndara të inteligjencës/referuar në	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Gjithsej 2011-2017
Policia e Kosovës	25	44	27	42	54	60	252
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës	1	0	1	9	7	4	22
Administrata Tatimore e Kosovës	17	21	21	23	26	40	148
Dogana e Kosovës	5	4	2	6	1	2	20
Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	0	0	0	4	0	1	5
Agjencia Kundër Korrupsionit	0	0	0	1	0	3	4
EULEX	7	2	2	1	13	2	27
FIU ndërkombëtare/Informacion Spontan	0	3	6	8	11	5	33
Tjera	0	0	0	0	0	2	2
Gjithsej raportet e shpërndara të inteligjencës	55	74	59	94	112	119	513

Tabela Nr.14 - Raportet e inteligjencës të shpërndara/referuara në institucione përkatëse 2012-2017



4.2. Mbikëqyrja e Pajtueshmërisë

Mbikëqyrja e pajtueshmërisë është vlerësimi i përmbushjes së obligimeve ligjore nga ana e subjekteve raportuese në pajtim me Ligjin.

Sipas nenit 34 të Ligjit mbikëqyrja e pajtueshmërisë mund të kryhet:

- si inspektim në vendin e subjektit raportues; apo
- si mbikëqyrje nga distanca e subjektit raportues

Mbikëqyrja e bazuar në rrezik është e ndërtuar në analizim të përgjithshëm të rrezikut, duke i renditur subjektet e mbikëqyrura në bazë të rrezikut dhe bën një përzgjedhje të bazuar në rrezik përmes analizimit të rrezikut të identifikuar nga subjektet raportuese dhe renditjes në bazë të rezultateve të vlerësimit kombëtar të rrezikut për PP/FT.

NJIF-K vendos një program vjetor për mbikëqyrjen (PVM) e pajtueshmërisë për subjektet e mbikëqyrura. PVM definon veprimet mbikëqyrëse dhe prioritetet gjatë vitit, si dhe shkallën e duhur të intensitetit mbikëqyrës, në linjë me kategorizimin e rrezikut fushave/modeleve të afarizmit dhe subjekteve të mbikëqyrura, si dhe resurset në dispozicion. Në rast të zhvillimeve të paparashikuara, amendamenti i PVM-së është i mundur gjatë gjithë vitit.

2017					
Subjektet raportuese	Lloji inspektimit				
	Fushëveprim i plotë	Fushëveprim i kufizuar	Inspektim Pasues	Ad-Hoc	Gjithsej
Banka	//	1	//	1	2
Institucione Mikrofinanciare	//	1	//	//	1
Kompani të Sigurimit	//	//	//	//	0
Kompani të Sigurimit të Jetës	//	//	//	//	0
Zyrat e Këmbimit Valutor	//	//	//	//	0
Agjensionet për transfer parash	1	1	//	//	2
OJQ	//	//	//	//	0
Auditor & Kontabilistë	//	//	//	//	0
Noterët	12	//	//	//	12
Agjensionet për patundshmëri	//	//	//	//	0
Gjithsej Inspektimet e Pajtueshmerise	12	3	0	1	17

Tabela nr.15 –Inspektimi i Pajtueshmërisë 2017

Gjatë vitit 2017 NJIF-K ka realizuar inspektime në vend dhe nga distanca. Gjithashtu, janë realizuar edhe inspektime në vend me fushëveprim të plotë, inspektime me fushëveprim të kufizuar si dhe inspektime Ad-Hoc.



Qëllimi i ushtrimit të inspektimeve në vend është për të fituar njohuri më të thella për subjektin në fokus, duke ndërvepruar me individët kyç përgjegjës për menaxhimin e pajtueshmërisë me PPP/LFT apo fushat specifike që janë subjekt i inspektimit, dhe për të pasur qasje në sistemin që subjekti i inspektuar përdor për pajtueshmëri dhe raportim.

Inspektimi i Pajtueshmërisë në vend 2014 - 2017					
Subjektet raportuese	2014	2015	2016	2017	Gjithsej
Banka	9	7	4	1	21
Institucione Mikrofinanciare	5	3	-	-	8
Kompani të Sigurimit	4	3	-	-	7
Kompani të Sigurimit të Jetës	2	-	-	-	2
Zyrat e Këmbimit Valutor	7	5	-	-	12
Agjensionet për transfer parash	3	2	-	1	6
OJQ	5	5	-	-	10
Auditor & Kontabilistë	-	1	1	-	2
Noterët	-	-	10	12	22
Agjensionet për patundshmëri	-	-	2	-	2
Gjithsej Inspektimet e Pajtueshmërisë	35	26	17	14	92

Tabela nr.16 –Inspektimi i Pajtueshmërisë në vend 2014-2017

Fushëveprimi i mundshëm i shqyrtimeve tematike të bazuara në zyrë, zakonisht është më i ngushtë se inspektimet në terren. Shqyrtimet tematike të bazuara në zyrë mund të përdoren për shembull në vlerësimin e udhëzimeve të brendshme të subjekteve në fushën e pajtueshmërisë me PPP/FT apo në shqyrtimin e proceseve të tyre të brendshme në pajtueshmërinë me PPP/FT.

Shqyrtimet tematike të bazuara në zyrë janë më të përshtatshme për inspektime ku NJIF-K dëshiron të bëjë një mbikëqyrje më të informuar të subjekteve të mbikëqyrura dhe udhëzimeve e proceseve të tyre të brendshme në fushat apo aktivitetet e përzgjedhura. Shqyrtimet tematike të bazuara në zyrë janë gjithashtu një mënyrë e mirë për të marrë pasqyrë të mirë të praktikave të mira/më të mira që ekzistojnë.

Në vitin 2017 me qëllim të vlerësimit të përmbushjes së obligimeve ligjore nga ana e subjekteve që kanë detyrime ose funksione sipas ligjit të mbajnë të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse përkatëse për fushën e tyre të përgjegjësisë. Kjo mbikëqyrje e realizuar ndaj tre sektorëve financiar, banka, institucione mikrofinanciare dhe agjensione të transferit të parave, ka identifikuar të disa dobësi tek këto subjekte për të cilat NJIF-K ka lëshuar rekomandime si masa për përmirësim. Për më tepër, NJIF-K ka iniciuar hartimin e akteve nënligjore, udhëzime për mbajtjen e statistikave.



Inspektimi i Pajtueshmërisë nga distanca 2017	
Subjektet raportuese	2017
Banka	10
Institucione Mikrofinanciare	15
Kompani të Sigurimit	-
Kompani të Sigurimit të Jetës	-
Zyrat e Këmbimit Valutor	-
Agjensionet për transfer parash	5
OJQ	-
Auditor & Kontabilistë	-
Noterët	-
Agjensionet për patundshmëri	-
Gjithsej Inspektimet e Pajtueshmërisë nga distanca	30

Tabela nr.17–Inspektimi i Pajtueshmërisë në nga distanca 2017

4.2.1. Ndëshkimet administrative dhe masat për përmirësim

Kur subjekti i mbikëqyrur, me dashje apo nga pakujdesia, shkelë një detyrim të përcaktuar në Ligj në një mënyrë që përshkruhet në nenet 41, 43 dhe 45, NJIF-K do të vendosë sanksione administrative për të ndëshkuar shkeljen e subjektit të mbikëqyrur.

Në vitin 2017, NJIF-K ka shqiptuar një (1) gjobë administrative. NJIF-K, pasi ka konstatuar se ekziston shkelje e dispozitave të ligjit për PPP/LFT, ka marr vendimin për shqiptimin e ndëshkimit administrativ për shkeljet për të cilat i është dhënë kompetencë sipas këtij ligji.

Gjatë përcaktimit të ndëshkimit administrativ merren në konsideratë të gjitha rrethanat relevante, duke përfshirë edhe shkallën dhe kohëzgjatjen e mos-përputhshmërisë, shkallën e përgjegjësisë, fuqinë financiare të subjektit raportues, humbjet e shkaktuar si pasojë e shkeljes, shkeljet e mëparshme si dhe nivelin e bashkëpunimit të subjektit raportues.

Po ashtu me qëllim të ndërmarrjes së masave përmirësuese, NJIF-K gjatë inspektimeve të ndërmarrura ka lëshuar gjithsej 91 rekomandime për masat që subjektet raportuese duhet t'i përmirësojnë me qëllim që të jenë në pajtueshmëri të plotë me ligjin.

4.2.2. Të dhënat statistikore dhe informatat kthyesë

Informatat kthyesë nga zbatuesit e ligjit ndaj informatave të dhëna nga NJIF-i mund të ndikoj pozitivisht në efektivitetin e kësaj Njësie. Nëse zbatohen në mënyrë efektive, do të zbusnin në masë të konsiderueshme mangësitë e identifikuara në raportet analitike, duke qenë se kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërinstitucional dhe harmonizimin e sistematizimin e të dhënave statistikore.



Informatat kthyesë të përcjella nga autoritetet tjera ka shënuar progres në vitin 2017. NJIF-K ka pranuar rezultatet e hetimeve në lidhje me 109 raste të përcjella paraprakisht për hetime të mëtutjeshme.

Informatat Kthyesë nga Institucionet tjera për NJIF-K	
Institucioni dërgues	2017
Policia e Kosovës	62
ATK	9
Dogana	38
Gjithsej informata kthyesë të pranuar nga NJIF-K	109

Tabela nr.18– Informatat Kthyesë nga Institucionet tjera për NJIF-K

Përveç institucioneve të sektorit publik, edhe subjektet raportuese obligohen të mbajnë të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse përkatëse për fushën e tyre të përgjegjësisë dhe të vihen në dispozicion të NJIF-K brenda afateve kohore të përcaktuara, për t'i mundësuar që të rishikojë efektivitetin e sistemit kombëtar dhe për të bërë rekomandime

NJIF-K ka kryer një inspektim të pajtueshmërisë tek subjektet e sektorit financiar për të vlerësuar mbajtjen e të dhënave statistikore nga subjektet në fjalë. Janë identifikuar mangësi në shumicën prej subjekteve të inspektuara. Për këtë qëllim, NJIF-K ka filluar me hartimin e nxjerrjes së akteve nënligjore, urdhra ose udhëzime për mbajtjen e statistikave.

Duke udhëzuar përmbajtjen e statistikave NJIF-K dhe BQK do të marrin informata të besueshme dhe gjithëpërfshirëse për mbikëqyrjen e pajtueshmërinë dhe kërkesave që dalin nga Ligji Nr. 05/L-096. Në këtë mënyrë statistikatat janë të qëndrueshme dhe të krahasueshme në kuadër të bankave dhe institucioneve financiare, si dhe ndërmjet tyre.

Objektiva e këtij udhëzimi do të jetë në mbështetje po ashtu të autoriteteve mbikëqyrëse për të matur rreziqet dhe verifikuar se si procesi i pajtueshmërisë dhe procedurat i zvogëlojnë rreziqet e identifikuar.

4.3. Aktivitetet e trajnimeve dhe implementimi i Programit të Trajnimeve

Më 20/04/2017, NJIF-K ka nxjerrë Udhëzim Administrativ MF (NJIF-K) Nr.02/2017 për trajnimet për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit. Përmes këtij udhëzimi administrativ përcaktohen kriteret dhe procedurat për obligimet ligjore lidhur me organizimin dhe kryerjen e trajnimeve të rregullta, përfshirë vetëdijesimin dhe sensibilizimin në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit, të përcaktuar sipas Ligjit Nr. 05/L-096 për PPP/LFT.

NJIF-K mund të organizoj dhe mbajë trajnime për PPP/LFT edhe në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet tjera, subjektet raportuese, mbikëqyrësit sektorial të subjekteve raportuese, si dhe odat dhe shoqatat përkatëse profesionale.



Trajnimet për PPP/LFT do të jenë të dizajnuara dhe strukturuara në atë mënyrë që gjatë moduleve të ndryshme të ju mundësojnë pjesëmarrësve të kuptojnë:

- Njohuri të përgjithshme mbi pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
- Përmbledhje sa i përket legjislacionit që ka të bëjë me PPP/LFT;
- Obligimet e raportimit të subjektit raportues të përcaktuara me ligjin për PPP/LFT dhe aktet tjera nënligjore;
- Tipologjitë e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe rrezikun të cilin mund të hasin subjektet raportuese dhe pasojat e mundshme të rrezikut të tillë;
- Procesin e mbikëqyrjes së pajtueshmërisë nga ana e NJIF-K apo mbikëqyrësve tjerë sektorial;
- Pasojat e mospajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi; dhe
- Çështje tjera të rëndësishme dhe relevante të fushës së PPP/LFT

Subjektet raportuese janë të obliguara të bëjnë sigurimin e organizimit dhe financimit të programit për trajnimin dhe aftësimin e të punësuarve mbi përgjegjësitë e parapara me legjislacionin në fuqi për PPP/LFT.

Në lidhje me vetëdijesimin e subjekteve raportuese përmes fushatave, trajnimeve, seminareve, konferencave etj, NJIF-K ka organizuar dhe mbajtur 4 trajnime dhe 2 punëtori, përmes së cilave janë trajnuar mbi 100 zyrtarë të ndryshëm nga zyrat e këmbimit valutor, BPCJF (Noter, Avokatë, Auditor, Kontabilist, Metalet e çmuara), Bankat komerciale, Institucionet Mikrofinanciare etj.

Përgjatë vitit 2017 janë organizuar disa trajnime, punëtori të cilat janë paraqitur në tabelën në vijim:

Data	Subjekti raportues	Tema	Organizator	Nr.i pjesëmarrësve
2/21/2017	Agjensionet për Transfer të Parave	Zbatimi i obligimeve ligjore sipas Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit	NJIF-K	4
4/19/2017	Zyrat e Këmbimit Valutor	Zbatimi i obligimeve ligjore sipas Ligjit Nr. 05/L-096 për PPP/LFT nga Këmbimoret	NJIF-K	26
5/17/2017	DNFBPs (Noter, Avokatë, Auditor, Kontabilist, Metalet e çmuara)	Trajnimet lidhur me LPP/LFT për Bizneset dhe Profesionet e Përcaktuar jo - Financiare	PECK II NJIF-K	26
9/11/2017	Bankat	Punëtori - Draftimi i legjislacionit sekondar në implementimin e ligjit për PPP/LFT: Indikatorët në PP/FT	Projekti i BE (B&S) NJIF-K	15
12/11/2017	Institucionet Mikrofinanciare	Trajnim lidhur me masat që duhet të ndërmerren nga institucionet Mikrofinanciare për PPP/LFT	Shoqata e Institucioneve Mikrofinanciare	15
10/10/2017	Bankat, Institucionet Mikrofinanciare, Agjensionet e Transferit të parave	Punëtori e grupit punues për rishikimin e Udhëzimit Administrativ për Personat e Ekspozuar Politikisht	PECK II NJIF-K	25

Tabela nr.19 –Trajnimet për subjektet raportuese 2017

Njësia për Inteligjencë Financiare në bashkëpunim dhe koordinimin të ngushtë me institucionet e zbatimit të ligjit dhe institucionet e tjera, mund të ofroj trajnime për institucionet të cilat bëjnë hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e veprës penale të pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit.

Në vitin 2017, zyrtarët e NJIF-K kanë ligjëruar në lidhje me temat e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit në disa trajnime ose punëtori të organizuara nga AD, GIZ etj. Pjesëmarrësit në këto trajnime ishin kryesisht Gjyqtarët, Prokurorët, hetuesit policorë etj.

Data	Institucionet	Numri i pjesëmarrësve	Tema	Mbështetësit
22/02/2017	Gjykata Prokuroria	15	Hetimi i krimeve financiare	Akademia e Drejtësisë
6/16/2017	Gjykata Prokuroria	15	Program i Specializuar Trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave- Sesion I	Akademia e Drejtësisë
6/29/2017-6/30/2017	Prokuroria, Policia, Dogana, NJIF	25	Punëtori në bashkëpunimin mes institucioneve në lidhje me hetimet financiare	GIZ
9/29/2017 - 9/30/2017	Gjykata, Prokuroria	8	Program i Specializuar Trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave- Sesion II	Akademia e Drejtësisë
10/5/2017-10/7/2017	Prokuroria, Policia, Dogana, NJIF	30	Punëtori në bashkëpunimin mes institucioneve në lidhje me hetimet financiare	GIZ
11/3/2017-11/4/2017	Gjykata, Prokuroria	10	Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave - Sesion III	Akademia e Drejtësisë

Tabela nr.20 –Trajnimet për institucionet e zbatimit të ligjit 2017

4.4. Aktivitetet e ngritjes së vetëdijes

NJIF-K është e autorizuar të bëjë vetëdijesimin dhe sensibilizimin në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit si dhe sa i përket detyrimeve ligjore të subjekteve raportuese. Kjo me qëllim të ngritjes së nivelit të parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit.

NJIF-K në bashkëpunim dhe mbështetje nga Projekti PECK II i Këshillit të Evropës kanë organizuar dhe mbajtur punëtorinë me sektorin publik dhe privat në lidhje me rishikimin e Udhëzimit Administrativ për Personat e Ekspozuar Politikisht dhe shtrirjen e saj me standardet ndërkombëtare.

Në këtë takim të grupit punues janë diskutuar mangësitë e Udhëzimit Administrativ ekzistues mbi Personat e Ekspozuar Politikisht dhe përafrimin e saj me standardet ndërkombëtare. Nga eksperti i Projektit u prezantua një Opinion Ligjor për shqyrtimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2014 për Personat e Ekspozuar Politikisht (PEP). Temat kryesore të diskutuara në këtë punëtori ishin: Korniza ligjore aktuale në Kosovë për Personat e Ekspozuar Politikisht – nevojat e identifikuar për amendamente dhe pajtueshmëri, Standardet ndërkombëtare dhe praktika e mirë lidhur me Personat e Ekspozuar Politikisht, Mangësitë e identifikuar dhe propozimet për përmirësim: përkufizimet bazë, kujdesi i duhur ndaj klientit, identifikimi dhe verifikimi i PEP-ve.

Përveç zyrtarëve nga NJIF-K, në punëtori ishin prezent edhe Ministria e Financave, Banka Qendrore e Kosovës, subjektet raportuese nga sektori financiar dhe Agjencia Kundër Korrupsionit. Pritet që Udhëzimi Administrativ të filloj një proces formal të ndryshimit, konsultimit dhe miratimit.



Burimi: PECK II

4.5. Ngritja e kapaciteteve të NJIF-K

4.5.1. Teknologjia Informativë

Me datë 31 Maj dhe 01 Qershor, një delegacion i NJIF-K i udhëhequr nga Drejtori kanë marrë pjesë në takimin e 4 të grupit të përdoruesve të goAML. Takimi është mbajtur në New York në selinë e Kombeve të Bashkuara. Qëllimi i këtij takimi ka qenë diskutimet rreth zhvillimeve të reja të goAML, zgjedhja e udhëheqësit të ri të projektit goAML dhe shpалosja e zhvillimit të produkteve goPORTFOLIO. Gjatë këtij takimi delegacioni i NJIF-K ka shfrytëzuar rastin për mbajtjen e disa takimeve, duke filluar nga homologët të cilët janë pjesë e grupit përdorues të goAML si dhe asistent Sekretaren Gjenerale të Kombeve të Bashkuara. Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës, mbetet e përkushtuar në zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.



4.5.2. Trajnime, konferenca, seminare dhe takime tjera të ndjekura nga personeli i NJIF-K

Ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit profesional të NJIF-K është synuar të arrihet përmes pjesëmarrjes në trajnime, kurse dhe seminare të ndryshme, ku kryesisht këto trajnime, zyrtarët nga njësia i kanë vijuar së bashku me zyrtarët e tjerë nga institucione tjera të zbatimit të ligjit në vend dhe jashtë vendit.

Mbi 20 trajnime dhe seminare vendore dhe ndërkombëtare janë ndjekur gjatë vitit 2017, ku ndër më kryesoret ishin:

- **Multilateral Information Exchange, Egmont Group Meetings i mbajtur ne Doha, Qatar, 1/2/2017**
- **Enforcement Agencies on TF Cases, Egmont Group Meetings i mbajtur ne Doha, Qatar, 2/2/2017**

- **Hetimi i krimeve financiare, organizuar nga Akademia e Drejtësisë, Prishtinë 22/02/2017**

- **FATF Private Sector Consultative Forum 2017 – NPOs, Vienna Austria, 22 Mars 2017**

Ky trajnim ka pasur për qëllim bashkëpunimin e OJQ-ve me institucionet tjera në veçanti me NJIF-ët, si dhe përfshirja e OJQ-ve në Vlerësimet e Rrezikut Kombëtar dhe atyre sektoriale, Vlerësimet e gjithëmbarshme të vendit me standardet ndërkombëtare (FATF, Moneyval etj), si dhe Rekomandimin 8 të FATF. Një zyrtarë i NJIF-K ka marrë pjesë në këtë trajnim, i cili ka qenë i mbështetur nga Projekti i BE i implementuar nga B&S.

- **Trajnim kundër Terrorizmit, organizuar nga Ambasada Britaneze, 18/4/2017 deri 21/4/2017**

- **Anticorruption series Financial Investigations Course. ILEA, Budapest, Hungary**

Nga data 8 deri më 12 Maj nën mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, dhe organizimin e ILEA Budapest, është organizuar kursi një javor me titull " Anticorruption series Financial Investigations Course", pjesëmarrës në të cilin përveç dy zyrtarëve të NJIF-K kanë qenë përfaqësues nga institucionet relevante të kësaj fushe nga vendet e ndryshme. Ekspert me përvojë nga SHBA kanë ligjërue në këtë trajnim.

- **Krimet e jakave të bardha, Krimi financiare dhe korrupsoni, Organizuar nga USDOJ - ICITAP i mbajtur ne Zagrep Kroaci, 15-19/05/2017**

Qëllimi i këtij trajnimi ka qenë njohja me përdorimin e teknikave të sofistikuar në hetimin të korrupsionit me fokus jakat e bardha, ndjekja e parave, vështrim i korrupsionit/mitdhënjes ndërkombëtare, grumbullimi i të dhënave financiare etj. Një zyrtarë i NJIF-K ka marrë pjesë në këtë trajnim.

- **Punëtori PECK II: Korniza ligjore në Kosovë në lidhje me zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare, / PECK II**



Më 10-11 maj 2017, është mbajtur punëtorja dy ditore në lidhje me masat kundër financimit të terrorizmit dhe legjislacioni për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare. Kjo punëtorja është mbajtur në Prishtinë dhe organizuar nga Projekti kundër krimit Ekonomik në Kosovë (PECK II).

- **AFCOS Seminar 2017 Mbështetje bashkëpunimit ndër-institucional në fushën e krimit ekonomik, mbajtur ne Budva, Montenegro,**

Në muajin qershor një zyrtare nga NJIF-K ka marrë pjesë në Seminarin AFCOS - Mbështetje bashkëpunimit ndër-institucional në fushën e krimit ekonomik të mbajtur në Budva, Mal të Zi.

- **Punëtorja nga iPROCEEDS “Punëtorja ndërkombëtare për të gjurmuar, ngrirë dhe konfiskuar asete që gjenerohen nga krimet kibernetike”, Luxemburg 12 - 13 Qeshor 2017**

Njësia për Inteligjence Financiare ka qenë pjese e punëtorisë së organizuar nga projekti i IPA-së, iPROCEEDS me temën “Punëtorja ndërkombëtare për të gjurmuar, ngrirë dhe konfiskuar asete që gjenerohen nga krimet kibernetike .

Kjo punëtorja është mbajtur me 12-13 Qershor 2017, në Luksemburg. Nga ky organizim pritet që të ndërtohen kapacitetet e bashkëpunimit mes institucioneve të Kosovës, Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Malit të Zi, Serbisë, Maqedonisë dhe Turqisë në hetimin e krimeve kibernetike dhe pastrimit të parasë, krimeve tjera të kryera Online që ndërlidhën me hetim financiar, bashkëpunimin për ndihim ndërkombëtare duke ngritur aftësitë në teknikat e hetimit, zhvillimet e fundit, etj.

Kryesisht objektiva e këtij organizimi ka qenë që të prezantohen praktikat më të mira, legjislacionet dhe rregulloret në fuqi , diskutimi i politikave të cilat ndërlidhën në aspekt të:

Për veç shteteve përfituese në këtë punëtorja kanë qenë zyrtare të NJIF Luksemburgu, Policia gjyqësore e Luksemburgut, Ekspert të Kshillit Europian dhe Bashkimit Europian, Zyrtare nga PAYPAL, Zyrtare nga Bitstamp, Zyrtare nga Amazon dhe zyrtare nga EC3 (EUROPIAN CYBERCRIME CENTER).

- **Punëtorja "Financimi i Terrorizmit dhe Pastrimi i Parasë", Departamenti i Drejtësisë, ICITAP, US DoJ,**



Burimi: ICITAP

Më 28 dhe 29 Qershor në Prishtinë është mbajtur punëtorja "Financimi i terrorizmit dhe shpërlarja e parasë". Kjo ngjarje është organizuar nga Programi Ndërkombëtar i Asistencës në Trajnim për Hetimet Penale (ICITAP) dhe Zyra Tejqeanike për Trajnim, Asistencë dhe Zhvillim Prokurorial (OPDAT) në Kosovë, në kuadër të Departamentit të Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara, me përkrahje dhe mbështetje të Njësisë së Inteligjencës Financiare dhe PK.

Punëtorja ka adresuar sfidat dhe zbrazëtirat potenciale në legjislacionin vendor, bashkëpunim dhe kapacitetet e gjitha institucioneve përgjegjëse për rregullim, trajtim dhe ndjekje të financimit të terrorizmit dhe shpërlarjes së parasë.

Pjesëmarrës në këtë punëtori kanë qenë zyrtarë vendorë dhe ndërkombëtar nga institucione të zbatimit të ligjit dhe institucionet tjera relevante të fushës së LPP/LFT.

- **Punëtori nga GIZ me titull "Workshop on cooperation between the institutions in regard to financial investigations", 29-30 Qershor 2017, Prizren**

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin zyrtarët nga agjensionet e ndryshme duke përfshirë Prokurorë, Hetues Policorë, Doganier. NJIF-K ka qenë e përfaqësuar në këtë punëtori me dy zyrtarë të saj.

- **Strengthening rule of law compliant criminal justice responses to terrorism, 5-6/7/2017, US Embassy, OSCE**

Nën mbështetjen e Ambasades Amerikane në Prishtinë dhe në bashkëpunim me OSCE, është mbajtur trajnimi dy ditor me temën "Forcimi i sundimit të ligjit në përputhje me reagimet e drejtësisë penale ndaj terrorizmit. Dy zyrtarë të NJIF-K ishin pjesëmarrës në këtë trajnim.


- **ISIL Phases I & II and Future TF Work, Egmon Group Plenray Meeting, Macao, 4 Korrik 2017**
- **Role and Capacities of FIU in Combating the Financing of Recruitment for Terrorist Purposes, 5 Korrik 2017**
- **New Payment Methods, Egmon Group Plenray Meeting, Macao 5 Korrik 2017**

- **Punëtorja "Mashtrimet financiare Online dhe mashtrimet përmes kredit kartelave", iPROCEEDS Project, Podgorica, Mali i Zi, 18-19 Qershor 2017**

Kjo punëtori ka pas si qëllim që përmes ngritjes së njohurive nga trendet e ndryshme dhe tipologjive të mashtrimeve financiare online dhe mashtrimeve përmes kredit kartelave të forcoj kapacitetet e aurotiteteve të zbatimit të ligjit për të gjurmuar, ngrirë dhe konfiskuar asetet e gjeneruara apo të përfituara nga krimet kibernetike.

Pjesëmarrës në këtë punëtori të organizuar nga iProceeds kanë qenë dy shtete: Mali i Zi dhe Kosova me përfaqësues nga drejtora e krimeve kibernetike, NJIF, prokuroria, hetimet e integruara financiare, gjyqësori, BQK dhe sektori privat.

Ky aktivitet është përbërë nga 11 sesione si në vijim:



1. Pasqyrë e përgjithshme mbi mashtrimet financiare online dhe mashtrimi përmes kredit kartelave në Kosovë dhe Mal të Zi. Trendet, Statistikat dhe raste studimore.
2. Mashtrimet BEC/CEO – Sfidat për të hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e tilla
3. Iniciativat e Interpollit kundër mashtrimeve CEO bazuar në teknikat ingjinerike sociale.
4. Krimet financiare online dhe mashtrimet , përfshirë ato në e-comerc
5. Trejetimi sekret në “tregun e errët” – Enkriptimi, valutat virtuale dhe tregu i errët (Darknet)
6. Tipologji mbi pastrimin e paras online
7. Trendet e fundit përmes mashtrimeve të kredit kartelave
8. Procedurat ligjore për të hetuar të ardhurat e gjeneruara nga krimet online
9. Pasqyrim i gjendjes gjenerale për hetim financiar mbi të ardhurat e gjeruara nga krimet online sipas standardeve ndërkombëtare
10. Bashkëpunimi ndërkombëtar për të hetuar krimet financiare për të ardhurat e gjeneruara nga krimet online. Metodatat, sfidat dhe bashkëpunimi mes institucioneve të zbatimit të ligjit.
11. Bitcoin – hetimet financiar të cilat nderlidhen: metodatat e gjurmimit dhe identifikimit të të dyshuarve, ruajtja dhe ngrirja e Bitcoineve.

- **Punëtori ndërkombëtar në kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave që gjenerohen nga aktivitetet kriminale në një mjedis online, iPROCEEDS project, Ljubljana, Slovenia**

Njësia për Inteligjence Financiare e Kosovës, ka qenë pjesë e punëtorisë rajonale për udhëzues dhe indikatorë për të parandaluar dhe detektuar të ardhurat që janë gjeneruar nga krimet kibernetike. Ky aktivitet është mbajtur në Lubjanë me 4-5 Tetor 2017.

- **Zhvillimi i kapaciteteve të agjencive të Kosovës dhe të prokurorisë speciale për të luftuar korrupsionin e nivelit të lartë, OSCE, 2 deri 6 Tetor 2017, Prishtinë**

- **Punëtori për bashkëpunimin e institucioneve lidhur me hetimin financiar, GIZ, Akademia e Drejtësisë, 4-7 Tetor 2017, Bogë**

Dy zyrtarë të NJIF-K kanë marrë pjesë në këtë punëtori të organizuar nga GIZ dhe Akademia e Drejtësisë. Pjesëmarrë tjerë ishin zyrtarë nga institucionet relevante përfshirë Prokurorë, Gjyqtarë, Policë Hetues, Doganier etj.

- **Strengthening Criminal Justice Institutions and the Rule of Law, United States Department of Justice, Dubrovnik, Croatia 16 - 20 October 2017**

Nën organizimin e Ambasades së SHBA-ve në Zagreb është mbajtur trajnimi një javor që kishte për qëllim forcimin e kapaciteteve të ndjekjes penale dhe zbatimit të ligjit me fokus në fushën e korrupsionit (prokurimit) dhe pastrimin e parave. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin gjitha vendet e Ballkanit Perëndimorë përfshirë edhe Ukarainën dhe Gjerogjinë.

- **Teknika e avancuara të hetimeve financiarer, PECK II, Prizren 29 - 30 Nëntor 2017**



5. BASHKËPUNIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR

5.1. *Bashkëpunimi dhe koordinimi vendor*

Bazuar në nenin 6, paragrafi 1.7 të Ligjit për PPP/LFT, 1.7. Bordi Mbikëqyrës i NJIF-K është i autorizuar të kryejë funksionin e mekanizmit përgjegjës koordinues për përcaktimin e orientimit të politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të bazuar në rreziqet e identifikuar, si dhe për ngritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional në pajtim me qëllimet e këtij ligji. Për këtë qëllim mund të ftojë edhe akterë tjerë nga sektori publik dhe privat. Për këtë qëllim, Bordi mund të krijojë grupe pune për të bashkërenduar aktivitetet në fushën e politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe përcaktimin e prioritetëve afatgjatë dhe afatshkurtra.

Gjithashtu, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik shërben si një mekanizëm kyç i bashkërendimit dhe mbikëqyrjes për veprimtaritë e të gjithë akterëve shtetëror në fushën e luftimit të krimit ekonomik, përfshirë PP dhe FT. Kjo zyre është krijuar me qëllim të rritjes së efikasitetit në ndjekjen penale të krimeve, sekuestrimin dhe konfiskimin e përfitimeve materiale që burojnë nga krimi


Sipas dispozitave të Ligjit për PPP/FT, Republika e Kosovës ka politika kombëtare kundër PP/FT dhe këto politika mbështeten në rreziqet e identifikuar. Kështu, sipas nenit 18, paragrafi 1 të Ligjit për PPP/FT, NJIF-K koordinon vlerësimin kombëtar të rrezikut të PP/FT dhe i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës në përcaktimin e politikave, strategjive dhe masave për menaxhimin e rrezikut dhe për të zvogëluar rreziqet e identifikuar

Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar një mekanizëm për hartimin, rishikimin, miratimin, implementimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018

Që nga viti 2014 janë hartuar Raportet e Gjendjes dhe pas miratimit nga Grupi Punues Qeveritar, janë publikuar në WEB të Ministrisë së Financave. Sekretariati mban takime të rregullta periodike dhe sipas nevojës.

Në Kosovë Mekanizmat kryesore të koordinimit dhe bashkëpunimit janë si në vijim:

- Bordi Mbikëqyrës i NJIF-K (neni 6 i ligjit për PPP/LFT)
- Mekanizmi përcjellës Strategjia 2014-2018
- Koordinator Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike
- Mekanizmi institucional i Strategjisë kundër krimit të organizuar 2017-2022
- Mekanizmi institucional i Strategjisë kundër Terrorizmit 2017-2022
- Mekanizmat monitorues për implementimin e strategjisë dhe planit të veprimit strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015 – 2020
- Mekanizmi për Shënjestrimin e rasteve të rënda (Targetimi i rasteve të krimeve serioze)
- Grupet punuese për hartimin e strategjive nacionale
- Grupet punuese për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar
- Mekanizmi përcjellës për hartimin e raporteve statistikore



- Grupet për caktim dhe koordinim të detyrave në kuadër të marrëveshjes gjithëpërfshirëse bashkëpunimi për shkëmbimin e informatave, vlerësimin e riskut dhe koordinim në mes të institucioneve dhe agjensioneve të zbatimit të ligjit për luftimin dhe parandalimin e krimeve ekonomike dhe financiare


Më datë 4 Prill 2017, Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi ka pritur në një takim një delegacion të NJIF-K të udhëhequr nga drejtori i Njesisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës, z.Dardan Nuhiu. Presidenti përgëzoi drejtorin Nuhiu për anëtarësimin e NJIF-it në Egmont Group. Drejtori Nuhiu u shpreh se anëtarësimi në Egmont Group është bërë pasi Kosova ka plotësuar të gjitha kushtet. Tani Kosova ka qasje në të dhënat që ndajnë të gjitha shtetet anëtare që do të kontribuojë në ngritjen e efikasitetit të NJIF-it, por edhe të sundimit të ligjit dhe luftimit të krimeve financiare në Kosovë në përgjithësi. Presidenti Thaçi u shpreh se NJIF-i, e ka merituar anëtarësimin dhe u shpreh se kjo është edhe një mirënjohje tjetër për të arriturat e Kosovës si shtet dhe hap tjetër në konsolidimin ndërkombëtar të shtetësisë së Kosovës. NJIF Kosova është anëtarësuar në Egmont Group në fillim të shkurtit.



Burimi: Presidenti i Republikës së Kosovës

5.1.1. Bashkëpunimi me Agjensionet e Zbatimit të Ligjit dhe institucionet tjera

Shkëmbimi i informative dhe bashkërendimi i veprimeve në mes NJIF-K dhe organeve tjera të zbatimit të ligjit me qëllim të parandalimit dhe hetimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ka qenë 15% më i lartë se vitin paraprak. Zyrtarët ndërlidhës nga Policia e Kosovës dhe Dogana kanë kontribuar në koordinimin e aktiviteteve në kuadër të kompetencave të tyre në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme.




Janë mbajtur takime me zyrtarë nga agjensionet e zbatimit të ligjit me qëllim të ndihmës dhe bashkëpunimit në mënyrë reciproke, ndihmës së njëra tjetrës gjatë kryerjes së detyrave të tyre si dhe koordinimit të aktiviteteve në kuadër të kompetencave të tyre në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme.

Në vitin 2017, numri i kërkesave për shkëmbim të informacioneve ka qenë 130, kërkesa këto të parashtruara nga autoritetet hetuese vendore ose të tjerat.

Policia e Kosovës vazhdon ta mbaj primatin e numrit më të madh të kërkesave të bëra. Ky vit shënon ngritje të numrit të kërkesave nga AKI:

Institucionet parashtruese të kërkesës	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Policia e Kosovës	28	57	91	52	45	53
AKI	5	14	23	19	28	31
EULEX	15	8	11	7	5	2
Prokuroria Speciale e Kosovës	4	1	6	3	1	2
Prokuroria e Shtetit	0	5	6	3	0	0
Administrata Tatimore e Kosovës	2	20	7	2	0	8
Dogana e Kosovës	44	61	25	15	22	21
ILECUs	2	15	6	6	6	6
Tjera	3	2	2	3	6	7
Gjithsej	103	183	177	110	113	130

Tabela nr.21 - Kërkesat për informata (IRD) të parashtruar nga institucionet bashkëpunuese të NJIF-K 2012-2017



Grafikoni 11: Shkëmbimi vendor i informacionit 2017

5.2. Bashkëpunimi me homologët e huaj dhe Grupin Egmont

Një nga komponentët e rëndësishëm të aktivitetit të NJIF-K është vendosja e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare dhe partnerët e huaj përgjegjës për trajtimin e masave efektive të LPP/LFT.

Gjatë vitit 2017, NJIF-K bashkëpunoi në mënyrë aktive me organizatat dhe institucionet kryesore ndërkombëtare të angazhuara në këtë fushë, siç është Grupi Egmont i Njësitë të Inteligjencës Financiare, Projekti PECK i Këshillit të Evropës, UNODC (goAML), Projekti "iPROCEEDS" i Këshillit të Evropës dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë.

Në kuadër të bashkëpunimit me grupin Egmont gjatë vitit 2017, NJIF-K ka kontribuar dhe përcjell tek Egmont Group informacionin në lidhje me Egmont Biennial Census 2017.

Që nga viti 2014, NJIF-K ka marrë pjesë në takimet Plenare dhe takimet tjera të Egmont Group si në vijim:

- 22nd Plenary Meeting of Egmont Group, Qershor 2014, Lima Peru (NJIF-K morri pjesë si vëzhguese),
- Egmont Working Group Meetings Berlin, Germany 27-28 Janar 2015 (NJIF-K morri pjesë si kandidat i mundshëm),
- Egmont Group WGs and HoFIU Meetings (Doha, Qatar), 29 Janar 2017 deri më 2 Shkurt 2017 (NJIF-K morri pjesë si kandidat) ,
- 24 Egmont Group Plenary Meeting In Macao, SAR China (NJIF-K morri pjesë si anëtar),
- Egmont Group WGs and HoFIUs Meeting, 12-15 Mars 2018 (NJIF-K morri pjesë si anëtar).

Për më tepër, përfaqësuesit e NJIF-K gjatë punësive ndërkombëtare kanë prezantuar përvojën e tyre dhe institucionale në fushën e LPP/LFT duke ndikuar kështu në përmirësimin e bashkëpunimit bilateral dhe ndërkombëtar.

5.2.1. Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve

NJIF-K siguron ndërveprimin dhe shkëmbimin e informacionit me autoritetet kompetente të shteteve të huaja, aktivitetet e të cilëve përfshijnë PPP / LFT.

Bashkëpunimi ndërkombëtar	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Gjithsej
KËRKESAT E PRANUARA							
Kërkesat e huaja të pranuar nga NJIF-i	10	7	19	18	16	33	103
Kërkesat e huaja të ekzekutuara nga NJIF-i	13	6	20	18	14	22	93
Kërkesat e huaja të refuzuara nga NJIF-i	0	0	0	0	0	0	0
Ndarja spontane e informacionit të marrë nga NJIF-i	0	2	1	1	1	7	12
GJITHSEJ (kërkesat dhe informacioni i pranuar)	23	15	40	37	31	62	208
Numri mesatar i ditëve për t'iu përgjigjur kërkesave të NJIF-ve të huaja	33	26	29	23	16	13	


Arsyet e refuzimit të zbatuara	0	0	0	0	0	0	0
KËRKESAT E DËRGUARA							
Kërkesat e dërguara nga Njif-i			25	18	13	37	93
Ndarja spontane e informacionit të dërguar nga Njif-i	0	3	6	8	11	5	33
GJITHSEJ (kërkesat dhe informacioni i dërguar)	0	3	31	26	24	42	126

Tabela nr.22 – Shkëmbimi ndërkombëtar i informatave 2012-2017

Numri i kërkesave ndërkombëtare për asistencë të bëra nga NJIF-K tek homologët e saj të huaja gjatë vitit 2017 u rrit ndjeshëm me vitin paraprak 2016 (një rritje prej 185%). Gjithashtu Numri i kërkesave për ndihmë të pranuar nga NJIF-K në vitin 2017 u rrit ndjeshëm se një vit më parë (një rritje prej 106%).

5.2.1.1. Shkëmbimi në kohë dhe konstruktiv i informacionit

Ditët mesatare për kthimin e përgjigjeve ndërkombëtare kanë vazhduar të shënojnë rënie edhe në vitin 2017, që cilësohet si progres në trajtimin e kërkesave të tilla për shkëmbim ndërkombëtar të informacionit. Për këtë qëllim, NJIF-K i kushton vëmendje të veçantë kërkesave të huaja dhe është duke bërë përpjekje për ekzekutimin në mënyrë efikase të kërkesave ndërkombëtare në kohë të duhur dhe pa vonesa të paarsyeshme.



Grafiku Nr.12 - Numri mesatar i ditëve për t'iu përgjigjur kërkesave të huaja


Në këtë kontekst, koha mesatare për kthimin e përgjigjeve në vitin 2017, ka qenë 13 ditë, i cili numër është më i vogli në pesë vitet e fundit.

5.2.1.2. Ndarja Spontane e Informacionit me NJIF-ët ndërkombëtare

Gjatë analizës NJIF-K mund të hasë informata të cilat mund të jenë relevante për NJIF-in e një shteti tjetër dhe i cili mund të paraqes interes për NJIF e vendit tjetër. Në rastet e tilla NJIF-K do të bëjë një shpërndarje spontane tek NJIF-i përkatës.

Në vitin 2017, NJIF-K ka pranuar 7 raporte spontane të inteligjencës nga 3 NJIF. Gjatë të njëjtës periudhë, NJIF ka përpiluar 5 raporte spontane të inteligjencës, të dërguara në NJIF-ët e 4 shteteve.





Grafiku nr.13 - Informacioni Spontan i shpërndarë nga NJIF-K 2013-2017

5.2.2. Bashkëpunimi rajonal

Drejtori i NJIF-K z.Dardan Nuhiu ka marrë pjesë në Konferencën Rajonale të udhëheqësve të FIU-ve të vendeve të rajonit, i cili është mbajtur në Brdo by Kranj, Slovenia më 6 deri më 8 Nëntor 2017.

Qëllimi i konferencës rajonale ishte forcimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit midis NJIF-ve në rajon, të cilat rezultojnë në një luftë më të suksesshme kundër pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit. Çështjet kryesore të diskutuara në këtë takim rajonal, adresonin temat që kishin të bënin me implementimin e Direktivës së IV të BE dhe legjislacionin kombëtar, Vlerësimin e rëndësive të 5 të Monyval dhe eksperiencën e vendeve, valutat virtuale dhe bazën ligjore, Tipologjitë e reja dhe trendët e PP/FT etj.

Pjesëmarrës tjerë në këtë konferencë ishin delegacionet nga Sllovenia, Kroacia, Serbia, Bosnia dhe Hercegovina, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi.

Në fund të Dhjetorit 2017, një delegacion i NJIF-K i udhëhequr nga Drejtori kanë kryer një vizitë pune në njësinë homologe në Shqipëri.

5.2.3. Memorandumet e Mirëkuptimit

NJIF-K gjatë vitit 2017 ka iniciuar lidhjen e dy marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërkombëtar, atë me njësinë homologe nga Jordania dhe Senegali. Këto marrëveshje pritet të nënshkruhen gjatë vitit pasues 2018. Deri në vitin 2017 janë nënshkruar gjithsej pesëmbëdhjetë (15) marrëveshje të bashkëpunimit në sferën ndërkombëtare.



5.2.4. Procesi i Anëtarësimit në organizata ndërkombëtare

5.2.4.1. *Grupi Egmont*



Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës bëhet anëtarja më e re e Egmont Group (rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në botë). Anëtarësimi i NJIF është një arritje e madhe për vendin në rrugëtimin tonë për anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

Ky anëtarësim do t'i kontribuoj luftimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

NJIF-K është bërë anëtarja e 153 e kësaj organizate ndërkombëtare, në takimin vjetor të Egmontit që është mbajtur në Doha të Katarit. Gjatë atij takimi është anëtarësuar në grupin Egmont edhe NJIF nga Cape Verde, që përbën një arritje të mëtejshme në kuadrin e zgjerimit të rrjetit global të inteligjencës financiare.




6. MENAXHIMI I RREZIKUT NË PASTRIM TË PARAVE DHE FINANCIM TË TERRORIZMIT

6.1. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit 2014-2018

Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit përbëjnë një mekanizëm të menaxhimit të rrezikut kombëtar nga fenomenet e dëmshme të trajtuara nga kjo strategji. Si mbështetje e kësaj strategjie janë krijuar edhe mekanizmat për hartimin, rishikimin, miratimin, implementimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018.

Ka vazhduar zbatimi i implementimit të planeve strategjike duke veçuar edhe Strategjinë Kombëtare dhe Planit të Veprimit të Republikës së Kosovës për Parandalim dhe Luftim të Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018. Ministria e Financave ka filluar rishikimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Është ri-dizajnuar sekretariati i implementimit të strategjisë. Janë bërë raportimet e rregullta periodike.

NJIF-K është një nga institucioneve kyçe për sa i përket implementimit të kësaj Strategjie dhe Planit të veprimit, për të cilën është autoriteti përgjegjës në lidhje me përmbushjen e shtatë (7) veprimeve të përcaktuara në planin e veprimit, përderisa institucion mbështetës ishte i përfshirë në gjithsej njëzet e dy (22) aktivitete. Deri në përfundim të vitit 2017, NJIF-K ka realizuar ose është në proces të implementimit të rreth 84% të aktiviteteve të planit të veprimit dhe indikatorëve matës.



Grafiku nr.14 - Statusi i implementimit të PV të Strategjisë 2014-2018

6.2. Vlerësimet e Rrezikut Sektorial

Pas përfundimit të Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2013, i cili është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës¹, përfshin përfundimin se ekonomia joformale, pastrimi i parave, financimi i terrorizmit dhe krimet financiare janë pandashëm të lidhura me njëra tjetrën. Në anën tjetër, Plani i Veprimit i Strategjisë Kombëtare 2014-2018 kërkon që autoritetet përkatëse me mbështetje të institucioneve tjera relevante duhet të implementojnë vlerësimin e rrezikut të sektorit dhe degëve specifike me fokus në sektorët dhe degët më të cenuara në ekonominë joformale dhe krimeve financiare. Kështu, NJIF-K vendosi të kryej vlerësimin e rrezikut të sektorit specifik në mënyrë që një proces i tillë do të identifikoj kërcënimet dhe dobësitë që kanë lidhje me ekonominë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet financiare.

Kështu në vitin 2014, NJIF-K dhe Grupi Punues vendosi që të fokusoj procesin në kompanitë e ndërtimit pasi është konsideruar të jetë njëri prej sektorëve më të cenueshëm në pastrim të parave. Ky vlerësim është rishikuar në vitin 2017. Ky vlerësim i rrezikut ka për qëllim të përdoret për hartimin, rishikim dhe amendamentim të politikave kombëtare, strategjive dhe instrumenteve tjera të menaxhimit të rrezikut. Në anën tjetër, rezultatet e vlerësimit të rrezikut duhet të përdoren gjatë fokusimit të aktiviteteve strategjike dhe operacionale të NJIF-K.

Ndërsa në fillim të vitit 2017, Grupi Punues i Vlerësimit të Rrezikut ka ndërmarrë edhe dy vlerësime të rrezikut sektorial për sektorë që është konsideruar që janë ndër të cenueshmit në PP/FT:

- Vlerësimi i Rrezikut Specifik Sektorial për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit mbi Lojërat e Fatit dhe kazinotë; dhe
- Vlerësimi i Rrezikut Specifik Sektorial për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit mbi OJQ-të

¹ më 18.12.2013



7. MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE

7.1. Projektet e financuar nga BE-ja&KiE

Më 13 Shkurt 2017, është lansuar Projekti i financuar nga BE "Mbështetje e mëtejshme Institucioneve të Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit".

Institucionet përfituese të këtij projekti janë Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Prokurorët, Gjykatësit, Policia e Kosovës, Hetuesit Financiarë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, Njësia për Inteligjencë Financiare, Banka Qendrore e Kosovës, komunat si dhe institucione dhe organizata tjera relevante

Objektiva e përgjithshme e këtij projekti është mbështetja e institucioneve të Kosovës në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar, përfshirë pastrimin e parave, korrupsionin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

Qëllimi i këtij projekti është që të forcohen mekanizmat për bashkëpunim ndër-institucional, rajonal dhe ndërkombëtar në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, përfshirë pastrimin e parave, korrupsionin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

Rezultatet e pritura që do të arrihen nga ky projekt janë:

- KOMPONENTI 1: Mbështetje Institucioneve të Kosovës në luftimin efikas të krimit të organizuar përmes përpjekjeve të fokusuara në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive.
- KOMPONENTI 2: Mbështetje Institucioneve të Kosovës në parandalimin efikas të, dhe luftimin e pastrimit të parave.
- KOMPONENTI 3: Mbështetje institucioneve të Kosovës në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar përmes bashkëpunimit dhe koordinimit efikas ndër-institucional.
- KOMPONENTI 4: Mbështetje institucioneve të Kosovës në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm.

7.1.1. Projekti i BE&KiE "Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë - Faza II (PECK II)"

Standardet ndërkombëtare dhe praktikrat e mira në lidhje me sanksionet financiare të synuara për financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes janë diskutuar në një seminar të organizuar nga Projekti i Përbashkët Bashkëpunimi BE / CoE kundër Krimit Ekonomik (PECK II) më 10 dhe 11 maj 2017.

Veprimtaria bashkon anëtarët e grupit punues ndërministror për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare të përbërë nga ministritë përkatëse, Zyra e Kryeministrit, institucionet e tjera përfituese qendrore EULEX dhe Zyra e BE-së. Anëtarët e grupeve punuese diskutuan mbi standardet përkatëse ndërkombëtare, veçanërisht Rekomandimet 6 dhe 7 të FATF dhe praktikrat e mira krahasuese të paraqitura nga eksperti i Këshillit të Evropës. Projekti PECK II do të vazhdojë të mbështesë Grupin Punues gjatë procesit të rishikimit të Ligjit për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare për të adresuar mangësitë ekzistuese në lidhje me sanksionet financiare të synuara në lidhje me financimin e terrorizmit

dhe financimin e përhapjes dhe për të siguruar më tej përputhjen me standardet relevante ndërkombëtare dhe praktikat e mira.

Projekti i përbashkët i BE / Këshilli i Evropës kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK II) organizoi një trajnim dy-ditor mbi rolin e bizneseve dhe profesioneve jofinanciare të caktuara (DNFBPs) në lidhje me pastrimin e parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit (LPP/LFT) që u mbajt më 16 dhe 17 maj 2017 në Prishtinë.

Trajnimi ka synuar shumicën e DNFBP-ve lokale të cilat sipas Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit përfshijnë ndërmjet të tjerash agentët e pasurive të patundshme dhe ndërmjetësit, avokatët, noterët, kontabilistët, auditorët dhe këshilltarët e taksave, tregtarët në metalet e çmuara dhe tregtarët në gurë të çmuar . Anëtarët e Shoqatës së Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK), Dhomën e Avokatëve, Dhomën e Noterëve, OJQ-të përkatëse dhe Njësinë e Inteligjencës Financiare (FIU) morën pjesë në këtë trajnim.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të dëgjonin nga eksperti i Këshillit të Evropës për standardet ndërkombëtare LPP/LFT, kërkesat legislative vendase, rreziqet dhe dobësitë tipike për kategoritë specifike të DNFBPs. Përmes prezantimeve dhe rasteve, përfaqësuesit e sektorit diskutuan me ekspertët e Këshillit të Evropës trendët aktuale dhe metodat e PP/FT, menaxhimin e rrezikut, identifikimin e flamujve të kuq dhe pajtueshmërinë.

Ky trajnim është pjesë e Projektit PECK II për të forcuar kapacitetet e NJIF-it dhe institucioneve të tjera të lidhura në fushën e LPP / LFT.



Burimi: PECK II

Më 7 dhe 8 qershor 2017, në Prishtinë, u zhvillua një mision scoping përfshirë një seminar mbi "Mbështetje për bashkëpunimin ndërmjet agjencive në fushën e krimit ekonomik". Përfaqësuesit

e Njesisë së Inteligjencës Financiare, Policisë, Administratës Tatimore, Doganave, Agjencisë Kundër Korrupsionit, Bankës Qendrore, Prokurorisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera relevante diskutuan praktikat aktuale lidhur me bashkëpunimin ndërmjet agjensive si dhe sfidat praktike të hasura në këtë drejtim.

Përveç kësaj, ekipi i Projektit zhvilloi takime bilaterale me institucionet përkatëse të zbatimit të ligjit, duke përfshirë komunitetin ndërkombëtar për të analizuar procedurat dhe praktikat ekzistuese të bashkëpunimit midis agjensive në fushën e krimit ekonomik. Informacioni i mbledhur gjatë misionit të zbulimit do të shërbejë si bazë për përgatitjen e një analize të përgjithshme të mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet agjensive në fushën e krimit ekonomik.

Me mbështetjen e Projektit të Përbashkët EU / Këshilli të Evropës kundër Krimit Ekonomik (PECK II), Dogana e Kosovës dhe Njësia e Inteligjencës Financiare nisën një fushatë ndërgjegjësimi mbi deklaratat e parasë së gatshme. Siç parashihet me Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit, të gjithë udhëtarët që hyjnë ose dalin nga Kosova janë të detyruar të deklarojnë para në dorë dhe instrumentet e tjera monetare në posedim të tyre. Në rast të mosdeklarimit ose deklarimit të pasaktë, sekuestrohet 25% e vlerës totale të deklaruar.

Fushata që filloi më 18 shtator 2017 përfshin postera, parulla vertikale dhe fletushka që janë vendosur në të gjitha pikat hyrëse dhe dalje të kufirit zyrtar. Përveç kësaj, një spot i animuar televiziv që ofron informacione dhe udhëzime të mëtejshme për deklarimin e mjeteve monetare dhe instrumenteve të tjera monetare transmetohet në Radio Televizionin e Kosovës (RTK).



Burimi: PECK II

Në kuadrin e projektit të përbashkët të BE / Këshillit të Evropës kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK II), Këshilli i Evropës organizoi një trajnim dy-ditor mbi teknikat e pastrimit të parave dhe teknikave të hetimit të krimeve financiare që u zhvilluan më 29 dhe 30 dhjetor 2017 në Prizren, Kosovë.

Trajnimi synonte hetuesit e institucioneve të zbatimit të ligjit, duke përfshirë Njësinë e Inteligjencës Financiare, Policinë, Doganat, Administratën Tatimore, Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Inspektoratin Policor. Aktiviteti synonte rritjen e kapaciteteve të teknikave të pastrimit të parave dhe të krimeve financiare duke përfshirë teknikat dhe mënyrën e operimit në zbulimin e pastrimit të parave dhe financave kriminale, përdorimin e teknikave të analizave financiare gjatë hetimeve komplekse, teknikave hetimore të zhvilluara përmes lëvizjes së parave të gatshme. Në një nivel praktik, pjesëmarrësit kanë mundësinë të rrisin njohuritë e tyre përmes diskutimit të rasteve studimore dhe duke punuar në ushtrime specifike të zhvilluara nga eksperti i Këshillit të Evropës, bazuar në përvojën konkrete evropiane në nivel shumëkombësh.

Më 18 tetor 2017, projekti i përbashkët i BE / Këshilli i Evropës kundër Krimit Ekonomik (PECK II) po paraqet një Dokument Teknik mbi "Rritjen e mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet agjencive përkatëse qeveritare në fushën e krimit ekonomik". Përfaqësuesit e Njësisë së Inteligjencës Financiare, Prokuroria e Shtetit, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Agjencia Kundër Korrupsionit, Policia e Kosovës, Dogana, Administrata Tatimore dhe shoqëria civile do të kenë mundësi të mësojnë nga eksperti i Këshillit të Evropës për analizën e hendekut të mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe mënyra për forcimin e këtyre mekanizmave


7.1.2. Projekti i KiE&BE "iPROCEEDS"

Ekspert të Bashkimit Evropian përmes projektit të IPA-se, iProceeds, me datë 30.01.2017 kanë hartuar një dokument "Udhëzues i përgjithshëm për Protokollin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për hetimet që përfshijnë produktet nga veprat penale online"

Qëllimi i këtij dokumenti është të sigurojë një burim referimi për agjensitë e përfshira në hetimin dhe ndjekjen penale të krimit kibernetikë dhe kontrollin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve nga veprat penale online dhe plotësimin e informacionit në udhëzuesin e përgjithshëm për Protokollin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për hetimet që përfshijnë produktet nga veprat penale online Dokumenti përmban aspekte dhe mundësi të ndryshme për bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, si dhe disa konsiderata në lidhje me protokollin e brendshme.

Ekspertët e Këshillit të Evropës kanë shqyrtuar dhe analizuar të gjithë legjisllacionin që ka të bëjë me PPP/LFT-në, si dhe dokumente të tjera në lidhje me këtë fushë dhe kanë përdorur të dhëna dhe informacione të mbledhura gjatë misionit vlerësues në terren në Kosovë në datat 19 - 20 Qershor 2017, ku u takuan me përfaqësues të disa institucioneve dhe organeve shtetërore.

Objekti kryesor i raportit është të parashtrojë një tërësi rekomandimesh për shtjellim të mëtejshëm dhe/ose përmirësim të udhëzimeve dhe treguesve për subjektet e sektorit financiar



me qëllim parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit nëpërmjet internetit dhe pastrimit të parave në një mjedis online. Raporti synon, gjithashtu, të trajtojë disa prej çështjeve ligjore dhe të politikave të identifikuar gjatë ciklit të projektit, të cilat mund të pengojnë përdorimin e efektshëm të udhëzimeve dhe të treguesve në praktikë.

Ndërsa, me date 30 Gusht 2017, është pranuar një raport vlerësimi i cili është gjeneruar ne baze te gjendjes ne teren. Ku raport është gjeneruar nga i njëjti projekt, i njëjti përmban: Gjetje dhe rekomandime për përmirësimin e udhëzimeve dhe treguesve për subjektet e sektorit financiar me qëllim parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit nëpërmjet internetit dhe pastrimit të parave në një mjedis online. Bazuar ne këtë raport dhe të gjetura NJIF-K ka përpiluar një liste me indikatorë të përbashkët me te raportit të vlerësimit dhe ka shtuar intensitetin e punës se bashku me institucionet tjera relevante qe kjo liste te publikohet nga mesi i vitit 2018.

7.2. Mbështetja nga UNDP

Luftimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është thelbësor për zbutjen e korrupsionit. Korrupsioni i madh që i përfshin zyrtarët publik e shkatërron besimin e publikut, e pengon zhvillimin ekonomik, e shtrembëron shpërndarjen e pasurisë dhe përfundimisht mund të sjellë trazira shoqërore. Për këtë arsye, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), përmes projektit të Përkrahjes së Përpjekjeve Kundër Korrupsionit në Kosovë (SAEK) që mbështetet nga Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim (SDC) dhe Agjencia Daneze për Zhvillim Ndërkombëtar (DANIDA), ka krijuar partneritetin me Njësinë e Inteligjencës Financiare të Kosovës (NJIF-K) për t'i ndërtuar kapacitetet e hetuesve financiar në zbulimin dhe ndjekjen penale të krimit financiar dhe në vlerësimin e trendëve të pastrimit të parave, gjë që do t'i ndihmonte proceset hetimore dhe riatdhesimin e aseteve të vjedhura. Si rezultat i analizimit nga afër të trendëve dhe rasteve rajonale dhe lokale, UNDP SAEK, në partneritet me NJIF-K, kanë filluar me zhvillimin e Tipologjive të Pastrimit të Parave që përfshijnë Persona të Ekspozuar Politikisht (PEP) me qëllim të ilustrimit të skemave të supozuara të pastrimit të parave, në mënyrë që të lehtësohet identifikimi i aktiviteteve të dyshimta dhe të përmirësohet zbulimi i hershëm, ndërprerja e aktiviteteve të jashtëligjshme, shkalla e suksesit e ndjekjeve penale dhe përfundimisht sasia e aseteve të vjedhura të riatdhesuara. Ky projekt pritet të publikohet në vitin 2018.

7.3. Mbështetja nga OSCE



Me 6 Tetor 2017, Shefi i Misionit të OSBE, Ambasadori Jan Braathu, vizitoi Njësinë e Inteligjencës Financiare të Kosovës dhe u takua me Drejtorin z. Dardan Nuhiu. Tema e diskutimit ka qenë puna dhe zhvillimet në NJIF-K dhe sfidat e saj, duke përfshirë kualifikimet e kufizuara në anën e gjyqtarëve

dhe prokurorëve, personat e ekspozuar politikisht, çështjet e personelit brenda Njesisë dhe mungesa mbikëqyrjes së pajtueshmërisë në lidhje me institucionet e lojërave të fatit në Kosovë. Z. Nuhiu e njoftoi ambasadorin Braathu se hetimi i financimit të terrorizmit do të jetë një tjetër prioritet i lartë i NJIF-it në të ardhmen, ndërsa nga ana e tij, Ambasadori Braathu premtoi mbështetje për NJIF-in.

Projekti “ Zhvillimi i kapaciteteve të agjencive të Kosovës dhe të prokurorisë speciale për të luftuar korrupsionin e nivelit të lartë ” të financuar nga Ambasada Gjermane dhe që implementohet nga Misioni I OSBE-së në Kosovë, Qershor 2017– Maj 2018

Misioni i OSBE-së ne Kosovë, konkretisht Sektori Këshillues Kundër Krimin të Organizuar pran Departamentit për Siguri dhe Rend Publik do të impletoj Projektin “Zhvillimi i kapaciteteve të Agjencive të Kosovës dhe të prokurorisë speciale për të luftuar korrupsionin e nivelit të lartë”.


Ky projekt është e financuar nga Qeveria Gjermane me ndërmjetësimin e Ambasadës Gjermane në Kosovë.

Më konkretisht projekti do të lehtësojë fuqizimin e kapaciteteve të një “Grupi Kyç” të hetuesve të Policisë së Kosovës dhe prokurorëve nga Zyra e Prokurorit Special (Task-Forca kundër korrupsionit) dhe zyrtarëve të Agjencionit Kundër Korrupsion për të hetuar rastet penale të korrupsionit të nivelit të lartë në një mënyrë efektive dhe efikase.

Megjithatë, hetimi i korrupsionit te nivelit të lartë pa asistencën dhe ndihmën e institucioneve dhe agjesioneve tjera si: Inspektorati Policor, Njësia për Inteligjence Financiare, Administratën Tatimore, Komisioni Rregullativë i Prokurimit Publik (KRPP), Doganat, Agjesionin Antikorupsion, Agjencia Kosovare e Privatizimit etj... është gjysmak apo edhe i pamundur.

Njësia për Inteligjence Financiare në Projekti “ Zhvillimi i kapaciteteve të agjencive të Kosovës dhe të prokurorisë speciale për të luftuar korrupsionin e nivelit të lartë ” të financuar nga Ambasada Gjermane dhe që është implementuar nga Misioni I OSBE-së në Kosovë, ka marrë pjesë në aktivitetet e poshtë cekura:

- Tryezë e rrumbullakët mbi aspektet ligjore në hetimin e korrupsionin e nivelit të lartë
- Seminar treditor mbi hetimin e krimit financiar, sekuestrimin/konfiskimin e pasurisë, hetimin e mashtrimit me tatime dhe shpëlarjes së parave 04-06 shtator2017,Pejë, Kosovë
- Trajnimi i avancuar mbi hetimin e krimeve financiare, 02-06 tetor 2017, Prishtinë



8. PLANI I PERFORMANCËS DHE RESURSEVE TË NJIF-K

Plani i performances dhe resurseve të NJIF-K, i hartuar nga Vlerësimet e Rreziqeve Kombëtare dhe atyre sektoriale, ka vazhduar me implementim nga përmbushje të aktiviteteve që dalin nga ky dokument strategjik.

Plani i performancës dhe resurseve përcakton se si NJIF-K do të ndërtoj kapacitetet e saj dhe të arriturat për t'i përmbushur dhe tejkaluar sfidat me të cilat do të ballafaqohet gjatë periudhës tri vjeçare dhe se si do të mirëmbajë pozitën e vet si një ndër njësitë efikase të inteligjencës në Kosovë dhe në rajon. Ky plan gjithashtu tregon se si NJIF-K do të matë suksesin e vet dhe si do të kontrollojë proceset e veta të brendshme.

Plani i Performances dhe Resurseve është ndarë në katër kapituj kryesor:


1. Prezantim i detyrave, misionit, vizionit, qëllimeve strategjike dhe organizimit të njësisë si dhe objektivat, planet e veprimit dhe indikatorët e performances;
2. Mjedisi Operativ i NJIF-K dhe Vlerësimi i Rrezikut;
3. Objektivat, zyrtarët përgjegjës, planet e veprimit dhe indikatorët e performances;
4. Burimet Financiare, njerëzore dhe të Teknologjisë Informative dhe Plani i sigurisë,objektit dhe zyrave të NJIF-K.

Ky dokument strategjik përcakton objektivat që duhet të përmbushen nga NJIF-K. Ai gjithashtu përmban planet se si t'i arrij ato objektiva dhe indikatorët kyç të performancës për të matur efikasitetin e njësisë. Janë përcaktuar 6 objektivat kryesore strategjike të NJIF-K për periudhën 2015-2017, të cilat janë paraqitur siç vijon:

1. Objektivi 1 – Rritja e vetëdijesimit dhe komunikimit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit;
2. Objektiva 2 – Promovimi i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe intensifikimi i mbikëqyrjes së pajtueshmërisë;
3. Objektiva 3 – Zhvillimi, standardizimi dhe intensifikimi i proceseve të raportimit, inteligjencës dhe analizave dhe promovimi i bashkëpunimit të agjencioneve për detektimin dhe hetimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit si dhe konfiskimit të të ardhurave nga krimi;
4. Objektiva 4 – Zhvillimi i legjisllacionit kombëtar PPP/LFT dhe standardeve të brendshme të NJIF-K dhe sigurimi i implementimit efikas të tyre;
5. Objektiva 5 – Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes proaktive ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit;
6. Objektiva 6 – Rritja e kapacitetit të NJIF-K.

Përmbushja e këtyre objektivave është synuar të arrihet përmes Planit Vjetor të Punës së Ministrisë së Financave dhe Planeve të Veprimit të Strategjive tjera Kombëtare.

Për më tepër, Plani i Performances dhe Resurseve përmban gjithashtu burimet financiare (buxhetin e NJIF-K), burimet njerëzore, vlerësimin e performances dhe ndërtimin e kapaciteteve të personelit të NJIF-K, teknologjinë informative dhe hapësirën punuese.



8.1. Grupet Punuese dhe Planet e Veprimit të Strategjive Nacionale

Raporti i gjendjes 2017² për implementimin e Planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018, tregon se është bërë në mënyrë të suksesshme nga njësia duke tejkaluar indikatorët kyç të performances të paraqitur në atë plan të veprimit. NJIF-K ka ndarë detyrat e punës për secilin aktivitet të cilat janë shpërndarë tek zyrtarët kompetent të njësisë, dhe raportimi është bërë në baza të rregullta periodike. Implementimin e objektivave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit të njësisë e monitoron anëtari i sekretariatit të Strategjisë, përderisa raportin e përmbushjes së atyre aktiviteteve e miraton Grupi i Përhershëm Qeveritar.

Për më tepër, kontributi i NJIF-K ka vazhduar në implementimin dhe rishikimin e strategjive kombëtare duke qenë pjesëmarrëse aktive në:


- Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018,
- Strategjinë Kombëtare kundër krimit të organizuar 2012-2017,
- Strategjinë Kombëtare kundër Terrorizmit 2012-2017,
- Strategjinë dhe planin e veprimit për implementimin e strategjisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm,
- Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA),
- Planin Vjetor të Punës së Qeverisë 2017, dhe
- Planin e punës së Ministrisë së Financave për Vitin 2017.

8.2. Objektivat e përcaktuara në Planin Vjetor të Punës së Ministrisë së Financave dhe Programin e Qeverisë

Në Planin Vjetor të Punës së Ministrisë së Financave (PVPMF) për Vitin 2017, janë përcaktuar katër 6 objektiva strategjike, të cilat rrjedhin nga Plani i Përfundimit dhe Resurseve të NJIF-K. cilatëto objektiva kanë si synim parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

1. Rritja e vetëdijesimit dhe komunikimit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit,
2. Promovimi i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe intensifikimi i mbikëqyrjes së pajtueshmërisë,
3. Zhvillimi, standardizimi dhe intensifikimi i proceseve të raportimit, inteligjencës dhe analizave dhe promovimi i bashkëpunimit të agjencioneve për zbulimin dhe hetimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe konfiskimit të të ardhurave nga krimi,
4. Zhvillimi i legjislacionit për PPP/LFT dhe standardeve të brendshme të NjIF-K dhe sigurimi i implementimit të tyre efikas,
5. Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes proaktive ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ,
6. Rritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të NjIF-K .

²Publikuar në <http://mf.rks-gov.net/>



Përbushja e këtyre objektivave është synuar të arrihet përmes njëzetepesë (25) aktiviteteve në të cilat NJIF-K është institucion përgjegjës. Këto aktivitete përbajnë në vete 67 masa (indikator). Nga aktivitetet që përmban ky plani i punës, gjatë këtij viti raportues 2017, NJIF-K ka filluar me zbatimin e rreth 94% e planit të punës.

Programi Qeveritar për vitin 2017 ka përmbajtur 4 aktivitete në të cilat NJIF-K përcaktohet të jetë institucion përgjegjës ose mbështetës. Kryesisht këto aktivitete përfshijnë:

- Përcjellja e aktiviteteve financiare të individëve apo grupeve radikale dhe ekstremiste si dhe Monitorimi dhe përpilimi i raporteve analitike të inteligjences, pastaj
- Promovimi i bashkëpunimit dhe koordinimin ndërmjet institucioneve si dhe rritja e bashkëpunimit me institucionet vendore të zbatimit të ligjit
- Ngritja e kapaciteteve në luftën kundër terrorizmit dhe financimit të terrorizmit
- Zbatimi në mënyrë sistematike të strategjisë dhe planit të veprimtimit të miratuar për luftimin e ekonomisë joformale .

8.3. Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA)

Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 16 dhjetor 2015, përmes Vendimit nr. 06/64, dhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 10 mars 2016, përmes Vendimit nr. 05-V-246. Si i tillë, PKZMSA është dokument ligjërish i detyrueshëm për të gjitha institucionet e Kosovës. Sipas Programit, secili organ i administratës shtetërore është përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të tij në kuadër të fushëveprimtimit të kompetencave të tij, respektivisht ashtu siç parashihet në kuadër të matricës së masave afatshkurtra.

NJIF-K si institucion për zbatimin e këtij programi kombëtar, në kuadër të matricës së masave afatshkurtra për vitin 2017, respektivisht zbatimit të nenit 89 të MSA-së, është përfshirë në dy kapituj:

- Kapitulli 4 i acquis-së: Lëvizja e lirë e kapitalit
- Kapitulli 24 i acquis-së: Drejtësia, liria dhe siguria

Në kuadër të këtyre kapitujve, NJIF-K është përcaktuar të jetë institucion përgjegjës ose mbështetës për zbatimin e PKZMSA në gjithsej 8 masa afatshkurtra:

- Korniza e politikave:
 - Rishikimi, azhurnimi dhe plotësim-ndryshimi I Planit të Performancës dhe Resurseve të Njësisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës 2015-2017.
 - Azhurnimi, ndryshim-plotësimi dhe hartimi i Procedurave Standarde të Operimit për të siguruar implementim të plotë dhe korrekt të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parasë dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe proceset efikase të punës në MF
 - Të dëshmojnë rezultate konkrete në fushën e luftimit të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.
 - Numri i rasteve/raporteve për transaksione të dyshimta, të shqyrtuara nga NJIF.

- Numri i informatave të shkëmbyera
- Në kuadër të reformave institucionale dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale janë përcaktuar veprimet vijuese:
 - Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve analitike të stafit të NJIF-K për parandalimin e pastrimit të parave, luftimin e financimit të terrorizmit dhe veprave të ndërlidhura penale,
 - Ngritja e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave në mes të NJIF-K dhe institucioneve homologe ndërkombëtare me qëllim të parandalimit dhe zbulimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe veprave të ngjashme penale.
- Si masa zbatuese në praktikë është përfshirë:
 - Zbatimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit të Republikës së Kosovës për Parandalim dhe Luftim të Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018,
 - Vlerësimi i rrezikut sektorial për sektorët më të ndjeshëm ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, krijimi i grupit punues dhe identifikimi i rrezeve për PPP/FT,
 - Monitorimi i aktiviteteve në kuadër të Strategjisë Kombëtare dhe Planin e Veprimit të Republikës së Kosovës për Parandalim dhe Luftim të Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2020
 - Rritja e vetëdijesimit dhe komunikimit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit

Me qëllim të përmbushjes së këtij programi kombëtar, NJIF-K ka raportuar rregullisht në baza periodike si dhe ka marrë pjesë në takimet e rregullta të Nën-Komiteteve për Drejtësi, Liri dhe Siguri. Sa i përket shkallës së zbatimit, të gjeturat tregojnë se në përgjithësi, në lidhje me zbatimin e masave nga NJIF-K nuk ka vonesa serioze dhe masat e planifikuara janë realizuar brenda afatit të paraparë.

8.4. Sfidat për të ardhmen në përmbushjen e planit të performances dhe strategjive tjera kombëtare

Sfidë për të ardhmen në përmbushjen e planit të performances mbetet:

- Nxjerrja e akteve të reja nënligjore të nevojshme për zbatimin e ligjit për PPP/PFT,
- Ndërmarrja e vlerësimit të rrezikut sektorial dhe specifik për fushat përkatëse me fokus në sektorët dhe fushat më të rrezikuara,
- Vlerësimi i rrezikut Kombëtar të PP/FT,
- Koordinimi i Vlerësimit për përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushat e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit (PPP/LFT)
- Ngritja edhe më tutje e vetëdijesimit dhe komunikimit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit,
- Promovimi i mëtutjeshëm i bashkëpunimit ndër-agjenci për zbulimin dhe hetimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit si dhe me fokus të veçantë në konfiskimin e të ardhurave nga krimi,
- Harmonizimi i statistikave dhe informatave kthyesë në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit,
- Përmbushja e aktiviteteve që dalin nga zbatimi i Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së,

- Anëtarësimi i NJIF-K në grupin rajonal të FIU-ve,
- Sigurimi i hapësirave punuese të përshtatshme të NJIF-K e cila do të përmbushte kërkesat e sigurisë dhe hapësirës së nevojshme punuese,
- Rritjen e kapaciteteve të NJIF-K me personel të ri dhe Modernizimi i Infrastrukturës së TIK-ut.





Rr. Eduard Lir Nr.1 – Arbëri – Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 38 247 105 – Fax: +381 38 247 103

<http://fiu.rks-gov.net>

fic@fic-ks.org